

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6779
E shtunë, 10 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

Pas zhvillimeve në veri, ambasadori amerikan takon liderët e opozitës

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**BRITANIA, ITALIA DHE JAPONIA
NISIN PUNËN PËR KRIJIMIN E NJË
AEROPLANI TË RI LUFTARAK F.2**

**BE-ja DHE QEVERIA E KOSOVËS
OFROJNË 45 BURSA
PËR PROGRAMET MASTER
NË UNIVERSITETET E BE-së F.3**

**BRITANIA VENDOS SANKSIONE
NDAJ MILAN RADOIÇIQUIT E
ZVONKO VESELINOVIQIT F.7**

EKONOMI



**KOMPANITË E SIGURIMEVE U
MUNDËSOJNË 450 MIJË
POLICËMBAJTËSVE PËRDORIMIN E
KLAUZOLËS SË NDËRMJETËSIMIT F.8**

**KDI-ja: IMUNIZIMI NDAJ
KORRUPSIONIT, PARAKUSHT PËR
NJË SHOQËRI PA KORRUPSION F.8**

SPORT



**SARAÇINI, EHF-SË: DËNOJMË
SJELLJET SHOVINISTE DHE FASHISTE
TË TIFOZËVE SERBË F.10**

AMBASADORËT E HUAJ DHE SHOQËRIA CIVILE KËRKOJNË QË TË SHTYHEN ZGJEDHJET NË VERI



Këshilltari i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier dhe ai i Gjermanisë, Jorn Rohde, kanë kërkuar që të shtyhet mbajtja e zgjedhjeve në veri pas situatës së fundit në këtë pjesë. Kërkesë të

njëjtë kanë edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile që monitorojnë zgjedhjet në Kosovë. "Mendojmë se këto zgjedhje duhet të shtyhen derisa koha të jetë e duhur dhe kur mund të mbahen pa nxitur më shumë joqëndrueshmëri dhe dhunë", ka deklaruar Derek Chollet



**KUVENDI,
QEVERIA DHE
NIVELI LOKAL
KANË NË PËRBËRJE
ZYRTARË QË
KANË PROBLEME
ME LIGJIN, FAQE 3**

**KUSH PO I SHËRMBEN
RUSISË NË VERI? FAQE 6**



Shkruan: Milazim KRASNIQI

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania, Italia dhe Japonia nisin punën për krijimin e një aeroplani të ri luftarak

LONDËR, 9 DHJETOR - Kryeministri britanik Rishi Sunak ka thënë se Britania do të bashkëpunojë me Italinë dhe Japoninë për të ndërtuar një aeroplan luftarak të gjeneratës së re. Sunak ka thënë se partneriteti në mbrojtje do të garantojë që Britania dhe aleatët të jenë "një hap përpara atyre që synojnë të na dëmtojnë".

Qeveria britanike synon që modeli i ri të mund të përdoret deri më 2035 dhe të shërbejë si pasardhës i modelit RAF Typhoon.

Ambicimet e Britanisë janë për krijim të një aeroplani të shpejtë - më të shpejtë sesa shpejtësia e zërit dhe që ai të ketë sensorë të avancuar dhe inteligjencë artificiale për t'i ndihmuar pilotit

në rast të mbingarkesës apo stresit të madh.

Modeli i ri - Tempest - pritet të ketë edhe kapacitet për të lëshuar armë hipersonike. Modeli i ri është duke u zhvilluar pas shqetësimeve të zyrtarëve ushtarakë se Britanisë është duke iu rrezikuar dominimi ajror.

"Siguria e Mbretërisë së Bashkuar, sot dhe për gjeneratat e ardhshme, do të jetë gjithmonë me rëndësi të veçantë për këtë qeveri".

Autoritetet britanike kanë thënë se edhe shtetet e tjera mund t'i bashkohen programit. Franca, Gjermania dhe Spanja veçse kanë nisur të punojnë së bashku për një dizajn tjetër ashtu sikurse Shtetet e Bashkuara.



Rreth 300 000 ukrainas "janë pajisur me pasaporta ruse"



MOSKË, 9 DHJETOR - Rreth 300 000 ukrainas janë pajisur me pasaporta ruse prej nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, sipas medias së pavarur ruse "Mediazona".

Rreth 70 000-80 000 personave u është dhënë shtetësia ruse vetëm në muajin tetor, sipas mediumit, i cili konsiderohet kritik i Kremlinit.

"Mediazona" ka thënë se raportimin e ka bazuar në të dhënat e Ministrisë së Brendshme në Moskë.

Shumica e aplikuesve kanë marrë pasaportë në rajonin rus Rostov-

on-Don dhe në Gadishullin ukrainas të Krimesë, të cilin Moskë e ka aneksuar më 2014.

Vala e aplikimeve është rezultat i faktit se qytetarëve u janë hequr të drejtat bazike nëse nuk kanë pasur pasaporta të Rusisë në territoret e pushtuara nga forcat ruse, ka raportuar "Mediazona".

"Ata shpesh nuk marrin trajtim shëndetësor apo mbështetje sociale pa pasaportë ruse", është thënë në raportim, transmeton dpa. Miliona njerëz janë detyruar të largohen nga Ukraina pas shpërthimit të luftës në fund të muajit shkurt. Sipas Kombeve të

Bashkuara, rreth 8 milionë ukrainas janë detyruar që të ikin në shtetet e tjera evropiane.

Sipas vlerësimeve ruse, rreth 4.5 milionë refugjatë ukrainas kanë hyrë në tokën ruse deri më tani.

Presidenti rus Vladimir Putin e konsideron luftën në Ukrainë si "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

ShBA-ja do të dërgojë më shumë trupa në Estoni

WASHINGTON, 9 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara do të dislokojnë numër shtesë të pjesëtarëve të këmbësorisë në Estoni "gjatë javëve në vijim" me qëllim që të forcohet mbrojtja në krahun lindor të NATO-s, thanë zyrtarët e mbrojtjes së Estonisë.

Ky dislokim konsiston në një grup të këmbësorisë amerikane - një njësit që zakonisht përbëhet nga 80 deri më 250 ushtarë, u tha në deklaratën e Ministrisë së Mbrojtjes të Estonisë. Së bashku me ushtarët do të dërgohen edhe sisteme

raketore të lëvizshmërisë së lartë, të njohur si HIMARS, por edhe pajisje të tjera ushtarake.

"Ky vendim shënon një shtim të konsiderueshëm të pranisë ushtarake të ShBA-së në Estoni dhe në shtetet e Baltikut, duke dëshmuar përkushtimin afatgjatë të ShBA-së sa i përket sigurisë së rajonit tonë dhe njëkohësisht duke forcuar mbrojtjen e NATO-s", tha ministri estonez i Mbrojtjes, Hanno Pevkur.

Javën e kaluar, Estonia, që gjendet në kufi me Rusinë, ka

njoftuar se do të marrë sisteme HIMARS për t'i forcuar kapacitetet e saj të mbrojtjes. Blerja e këtyre sistemeve është projekti më i madh i mbrojtjes i këtij shteti që kap vlerën mbi 200 milionë dollarë.

Përmes një deklaratë të ndarë, Ambasada Amerikane në Tallin tha se trupat amerikane janë pjesë e trupave të NATO-s që diskohen përmes rotacionit. Për dislokimin e këtij kontingjenti, NATO ishte pajtuar gjatë samitit të mbajtur më herët gjatë këtij viti në Madrid.



Gazetarët e "New York Times" në grevë 24-orëshe

NJU-JORK, 9 DHJETOR - Qindra gazetarë dhe punonjës të tjerë të së përditshmes amerikane "New York Times" kanë hyrë të enjten në grevë për herë të parë në më shumë se 40 vjet. Gazetarët dhe anëtarë të tjerë të

sindikates së Nju-Jorkut "NewsGuild" thonë se u ka humbur durimi nga zvarritja e negociatave për një marrëveshje, që kur kontrata e tyre skadoi në mars të vitit 2021.

Sindikata "NewsGuild", që

përfaqëson punonjësit që janë në grevë, njoftoi javën e shkuar se 1 100 punonjës do të hynin në grevë nga mesnata e së enjtes nëse palët nuk arrinin një marrëveshje për kontratat e tyre.

Kuvendi, qeveria dhe niveli lokal kanë në përbërje zyrtarë që kanë probleme me ligjin

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), në kuadër të Javës Kundër Korrupsionit, ka publikuar të premtën raportin e titulluar "Qeverisja me duar të pastra".

Hulumtuesi i IKD-së, Ramiz Durmishi, ka thënë se udhëheqja e institucioneve nga persona me dënime apo aktakuza aktive zbeh besimin e publikut. Sipas tij, qeverisja me duar të pastra rregullisht ishte premtuar nga i gjithë spektri politik, duke shtuar se një gjë e tillë po del të jetë vështirë e realizueshme në vendin tonë.

Ai ka bërë me dije se nga gjetjet e IKD-së në këtë raport, rezultojnë se premtimet e kryeministrit Albin Kurti, se nuk do të ketë ministra me aktakuza, nuk qëndrojnë. "Pra, gjetjet tregojnë se 9.16 për qind e përfaqësuesve të popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë persona të cilët kanë probleme me ligjin. Pra, nga gjithsej 120 deputetë, 11 prej tyre janë persona të cilët kanë aktakuza aktive për vepra të ndryshme, përfshirë ato korruptive", ka thënë Durmishi. Ai ka theksuar se tre prej deputetëve të cilët kanë probleme me ligjin janë duke ushtruar mandatin e tyre derisa janë duke u akuzuar për veprime korruptive. "Dy prej këtyre deputetëve, Mimoza Kusuri-Lila dhe Jetmire Vrenezi, janë nga Grupi Parlamentar i LV-së, si grupi më i madh parlamentar. Të dy këto raste kanë përfunduar në shkallë të parë, ku znj. Kusuri-Lila në shkallë të parë është shpallur e pafajshme derisa znj. Vrenezi në shkallë të parë është dënuar me burgim efektiv", ka thënë Durmishi. Sipas tij, deputetët të cilët IKD-ja i ka identifikuar se kanë probleme me ligjin janë nga tri parti parlamentare, sipas tij, 7 deputetë janë nga LV-ja, 1 nga PDK-ja dhe 2 nga AAK-ja si dhe një deputet pa grup parlamentar.

Durmishi ka thënë se me aktakuzë korruptive është duke



u përballur edhe deputeti Pal Lekaj, deputet ky nga radhët e grupit parlamentar të AAK-së. Në fund ai ka thënë se edhe shumë deputetë të tjerë kanë probleme me ligjin, të cilat ndërlihen me vepra të tjera penale. Sipas tij, përtej kësaj janë tre deputetë të këtij kuvendi të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptim të veprave penale korruptive, duke shtuar se një gjë e tillë do të duhej të konsiderohej si shumë shqetësuese.

Ndërsa Medina Kadriu, hulumtuese në IKD, ka thënë se në Kosovë ende nuk është krijuar kultura qeverisëse për të dhënë dorëheqje zyrtarët publikë që kanë probleme me ligjin. Sipas Kadriut, në demokracitë e konsoliduara sfera publike shërben si mjet kryesor i shoqërisë për ta dalluar krimin prej politikës.

Më tutje, Kadriu tha se në secilën shoqëri demokratike, zyrtarët e lartë të shtetit, politikanët dhe të gjithë ata që mbajnë përgjegjësi publike, u nënshtrohen normave etike që i përcakton shoqëria. Sipas saj, secili zyrtarit që hetohet për

krime, publiku i kërkon automatikisht dorëheqjen nga përgjegjësitë publike.

Më tutje, ai tha se kodi etik, gjithnjë nën vëzhgimin e publikut, funksionon aq mirë sa që rrallë ndodh që dorëheqja të kërkohej, zyrtarët që janë nën hetime zakonisht dorëheqen menjëherë me t'u bërë publike dyshimet për lidhjet e tyre me krimin.

Kadriu ka theksuar se gjetjet e IKD-së dëshmojnë se nga të gjithë zyrtarët që aktualisht kanë probleme me ligjin, asnjë prej tyre nuk ka dhënë dorëheqje.

Ajo ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës përbëhet nga gjithsej pesë zyrtarë të cilët kanë probleme me ligjin ku, sipas saj, tre nga këta zyrtarë, përfshirë edhe kryeministrin, kanë probleme me ligjin për shkak të veprimeve të hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kadriu shtoi se në këtë qeverisje edhe ministrja e MINT, Rozeta Hajdari, akuzohet për korrupsion, konkretisht për mosraportim apo raportim të rremë të pasurisë. Sipas

Kadriut, ministrja Hajdari gjatë kësaj kohe do ta ushtrojë detyrën e saj publike, pra do ta mbajë pozitën e ministres, duke qenë e akuzuar për korrupsion, në kundërshtim me premtimet qeverisëse.

Kadriu ka thënë se në grupin e personave që kanë probleme me ligjin, por se jo për korrupsion, bën pjesë edhe kreu i qeverisë, kryeministri Albin Kurti, i cili është i dënuar për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm dhe pengim të personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare. E sipas saj për vepra penale në kontekst të hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvend, Albulena Haxhiu ka një dënim penal të formës së prerë dhe një aktakuzë aktive. Për vepra penale në këtë kontekst, aktakuzë aktive ka edhe ministrja Arbërie Nagavci, derisa ministri Xhelal Sveçla akuzohet për "pjesëmarrje në turmë që kryen vepra penale dhe huliganizëm".

Në fund Kadriu ka thënë se tri komuna të Republikës së Kosovës, ajo e Klinës, e Podujevës dhe e Kamenicës

udhëhiqen nga persona që kanë probleme me ligjin.

Ajo ka deklaruar se komuna e Podujevës udhëhiqet nga Shpejtim Bulliqi, i dënuar me 500 euro për lëndim të lehtë trupor. "Komuna e Klinës udhëhiqet nga Zenun Elezaj, i cili ka aktakuzë aktive, e cila është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit, derisa në shkallë të parë Elezaj është dënuar me 4 mijë euro gjobë për konflikt interesi. Me aktakuzë aktive është edhe kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, i cili është i akuzuar për pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare", ka thënë Kadriu.

Java Kundër Korrupsionit organizohet nga Koalicioni i OJQ-ve, ku pjesë e këtij koalicioni janë 6 organizata: Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Lëvizja Fol, Iniciativa për Progres, Çohu dhe Columbus. Motoja e "Javës Kundër Korrupsionit për vitin 2022", e koalicionit të OJQ-ve, është "Bashkë Kundër Korrupsionit".

BE-ja dhe Qeveria e Kosovës ofrojnë 45 bursa për programet master në universitetet e BE-së



EU Scholarships for Master Studies
Fully funded Round XIII

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Kosovës së fundmi publikuan thirrjen e 13-të për aplikime për programin e BE-së të bursave pasuniversitare Young Cell Scheme.

Thirrja do të jetë e hapur deri më 27 dhjetor 2022 dhe mund të aplikojnë të gjithë studentët e diplomuar, pasuniversitarë dhe nëpunësit civilë nga Kosova të cilët janë të lindur pas 1 janarit 1988.

Aplikuesve të suksesshëm do t'u ofrohet mundësia për të studiuar në programet master

një ose dyvjeçare në një nga universitetet në shtetet anëtare të BE-së. Programi do të ofrojë deri në 45 bursa të plota, ndërsa studimet do të jenë në gjuhën angleze. Kjo thirrje është, ndër të tjera, e hapur për të diplomuar në drejtësi, administratë publike, menaxhim të burimeve njerëzore, ekonomi, financa, menaxhment, energji, mjedis dhe ndryshime klimatike, transport, shkenca të aplikuara dhe shkenca sociale. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë ose të ndryshme

dhe gratë inkurajohen fuqimisht të aplikojnë. Të gjithë aplikuesit e interesuar duhet ta vizitojnë faqen e mëposhtme <https://ycskosovo.org> për t'u regjistruar dhe për të marrë udhëzime të mëtejshme. BE-ja dhe Qeveria e Kosovës bashkërisht e financojnë programin në vlerë prej 6 milionë eurosh. Thirrja e 13-të zbatohet nga Konsorciumi i Universitetit "Aristotele" të Selanikut nga Greqia dhe Institutit Kombëtar të Shërbimit Publik nga Franca.



Ambasadorët e huaj dhe shoqëria civile kërkojnë që të shtyhen zgjedhjet në veri

Këshilltari i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, dhe ai i Gjermanisë, Jorn Rohde, kanë kërkuar që të shtyhet mbajtja e zgjedhjeve në veri, pas situatës së fundit në këtë pjesë. Kërkesë të njëjtë kanë edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile që monitorojnë zgjedhjet në Kosovë. “Mendojmë se këto zgjedhje duhet të shtyhen derisa koha të jetë e duhur dhe kur mund të mbahen pa nxitur më shumë joqëndrueshmëri dhe dhunë”, ka deklaruar Derek Chollet

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Në pjesën e veriut janë shtuar forcat policore. Tensionet në këtë anë të Kosovës, të banuar me shumicë serbe, janë në rritje. Një natë më herët, në Zveçan, një pjesëtar i Policisë së Kosovës mbeti i plagosur nga një sulm i armatosur.

Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë fajësuar “bandat kriminale serbe” për incidentet, ndërkaq përfaqësuesit e Serbisë kanë thënë se Kosova po përpiqet “ta pushtojë” veriun. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka caktuar 18 dhjetorin datë të mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të

komunave në veri.

Katër komunat e banuara me shumicë serbe, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, janë pa kryetarë që nga 5 nëntori.

Kryetarët e komunave, të nacionalitetit serb, dhanë dorëheqje në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin për regjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe.

Këshilltari i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, i tha “Zërit të Amerikës” se zgjedhjet për kryetarë të komunave në veri të Kosovës duhet të shtyhen dhe se për këtë çështje do të diskutojë me

udhëheqësit e Kosovës gjatë vizitës së tij në Prishtinë javën që vjen.

Chollet ka theksuar se Shtetet e Bashkuara mendojnë se “nuk është koha e duhur për zgjedhje duke pasur parasysh ndjeshmërinë e momentit dhe kemi parë dhunë në 24 orët e fundit”. “Është kohë e tensionuar dhe duam të sigurohemi se ka kushte për të mbajtur zgjedhje të lira dhe të drejta. Kosova është demokraci shumetnike sikurse Shtetet e Bashkuara. Ne jemi krenarë me punën që Shtetet e

Bashkuara kanë bërë në këto 20 e ca vjet për ngritjen e demokracisë në Kosovë dhe duam të punojmë për ta mbështetur dhe ruajtur atë. Së këndejmi, mendojmë se këto zgjedhje duhet të shtyhen derisa koha të jetë e duhur dhe kur mund të mbahen pa nxitur më shumë joqëndrueshmëri dhe dhunë”, ka deklaruar Chollet.

Edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka theksuar se nuk ka kushte për një proces të tillë. Zgjedhjet “nuk mund të mbahen me zor”, ka

deklaruar edhe kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi.

Të premtën shtyrjen e zgjedhjeve në veri e ka kërkuar edhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde. “Jam dakord me kolegun tim amerikan (Jeffrey Hovenier) që zgjedhjet duhet të shtyhen. Është e qartë se situata aktuale nuk është e favorshme për mbajtjen e tyre tani”, ka shkruar në “Twitter” Rohde.

Edhe sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile që monitorojnë zgjedhjet në Kosovë, procesi në

Osmani: Në territorin e Kosovës kurrë më nuk do të ketë policë dhe ushtarë të Serbisë

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka reaguar në lidhje me situatën në veri. Osmani ka shkruar në “Facebook” se kërcënimi i hapur për agresion policor e ushtarak nga ana e Serbisë dëshmon se në atë shtet vazhdon mendësia hegjemoniste. “Kjo duhet të refuzohet e kundërshtohet qartë nga e gjithë bota demokratike, e cila i dha goditjen më të

fuqishme kësaj mendësie pikërisht në vitin 1999. Plagosja e mbrëmshme e një pjesëtari të Policisë së Kosovës është veprim kriminal dhe i orientuar kundër rendit kushtetues e sovranitetit të Kosovës si dhe kundër veprimeve për sundim të rendit e ligjit. Gjithashtu, sulmet ndaj gazetarëve përbëjnë cenim flagrant të të drejtës për informim të lirë”, ka shkruar

Osmani. Ajo ka theksuar se autorët e këtyre krimeve urgjentisht të sillen para drejtësisë, ndërkaq institucionet e drejtësisë duhet të veprojnë menjëherë. “Në territorin e Republikës së Kosovës kurrë më nuk do të ketë policë dhe ushtarë të Serbisë! Ëndrra hegjemoniste e Serbisë nuk do të jetësohet kurrë!”, ka shkruar presidentja Osmani

Pas zhvillimeve në veri, ambasadori amerikan takon liderët e opozitës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka zhvilluar takime të veçanta me liderët e partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Hovenieri me Memli Krasniqin, Lumir Abdixhikun dhe Ramush Haradinajn kanë diskutuar për zhvillimet në vend, veçanërisht për situatën e fundit në veri.

Lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka bërë me dije se ambasadorin Hovenier e ka informuar për

qëndrimin e PDK-së rreth ngjarjeve në veri. “Në këtë takim diskutuam për zhvillimet e fundit politike në Kosovë, me theks të veçantë gjendjen e sigurisë në pjesën veriore të vendit dhe procesin zgjedhor në katër komunat atje. Ambasadorin Hovenier e informova për qëndrimin e PDK-së rreth këtij procesi. Ne i jemi përgjigjur dekretit të presidentes për këtë proces zgjedhor dhe në respektim të afateve dhe ligjeve kemi propozuar kandidatët tanë për kryetarë dhe asamblistë në katër komunat në veri. Presim nga qeveria dhe institucionet e Kosovës që të sigurojnë kushtet e favorshme për mbarëvajtjen e



procesit zgjedhor. Garantimi i sigurisë për secilin qytetar të Republikës së Kosovës duhet të jetë prioritet kryesor”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

Edhe lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka treguar për takimin që ka pasur ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier. “Bashkë diskutuam për zhvillimet e fundit politike në vend, me theks të veçantë gjendjen e sigurisë në Republikën e Kosovës. LDK beson se koordinimi i ngushtë i institucioneve të vendit me aleatët tanë strategjikë është garanci e sigurisë sonë nacionale dhe e rrugëtimit tonë

euroatlantik”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”. Ambasadori Hovenier ka takuar

edhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj. “Bashkë diskutuam për zhvillimet e fundit në vend, me theks të veçantë për situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës. Për Aleancën, partneriteti strategjik me ShBA-në është jetik. Andaj, improvizimet dhe largimi nga këshillat amerikane në një periudhë kur situata është shumë e brishtë, janë të dëmshme e mund t'i kushtojnë Kosovës”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Haradinaj ka falënderuar ambasadorin amerikan për mbështetjen e vazhdueshme që ShBA-ja i jep Kosovës dhe për angazhimin e tij personal që është shumë i rëndësishëm në këtë periudhë.



veri duhet të shtyhet për një afat të pacaktuar. Demokracia në Veprim (DnV) ka theksuar se që nga shpallja e datës së zgjedhjeve në katër komunat veriore nga presidentja e vendit, si rezultat i dorëheqjeve të kryetarëve të komunave në veri të Kosovës, procesi i organizimit të këtyre zgjedhjeve është përcjellë me probleme të shumta. “Procesi është përcjellë nga bojkotimi i garës zgjedhore nga kandidatët e komunitetit serb që, në fakt, përbën shumicën absolute të popullsisë në këto komuna. Dorëheqjet e zyrtarëve përkatës zgjedhorë të këtyre komunave e kanë vështirësuar organizimin adekuat të këtyre zgjedhjeve, ndërsa rastet e djeshme të incidenteve dhe dhunës në atë pjesë kanë pamundësuar vazhdimin e përgatitjeve për administrimin e procesit zgjedhor”, thuhet në reagimin e DnV-së.

DnV rikujton që ndër parimet kryesore të zgjedhjeve është ‘votimi i lirë’. “Zhvillimi i të gjitha procedurave nën forca të shumta të sigurisë, si dhe nën kërcënimin direkt të jetës së zyrtarëve zgjedhorë, por edhe qytetarëve dhe kandidatëve, bie ndesh me këtë parim. Kësisoj, është e qartë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka pothuajse të pamundur që t'i realizojë operacionet përkatëse zgjedhore për mbajtjen e rregullt dhe normale të këtyre

zgjedhjeve. Madje KQZ-ja e ka pasur të pamundur që një gjë të tillë ta bëjë edhe me asistencën e policisë. Bazuar në këtë situatë, është vështirë e besueshme që do të mund të garantohet siguri në këto komuna për qindra persona të angazhuar si staf zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, si dhe mijëra qytetarë me të drejtë vote. Për më tepër, probleme mund të ketë edhe me hapjen e qendrave të votimit”, ka theksuar DnV-ja, duke shtuar se në rrethanat aktuale të mungesës së sigurisë për stafin zgjedhor, mungesën e kandidatëve të komunitetit serb në garë, si dhe gjasave të pakta për pjesëmarrje të qytetarëve në zgjedhje, DnV kërkon nga presidentja e vendit që t'i iniciojë konsultimet me aktorët relevantë për t'i shtyrë zgjedhjet në katër komunat veriore.

Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se në veri nuk ka kushte të mbahen zgjedhjet. “KMDLNj vlerëson se nuk ka kushte elementare të mbahen zgjedhjet e shpallura nga presidentja e Kosovës. Raportet nga KMDLNj në Mitrovicë rekomandojnë që këto zgjedhje të mos mbahen dhe të shtyhen për një kohë më të përshtatshme, aq më parë që askush nuk mund të garantojë sigurinë për votuesit sikur edhe vendet ku duhet të mbahen këto zgjedhje”, është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.



Kurti: Policia e Kosovës nuk është e orientuar kundër serbëve

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se organet e sigurisë nuk e përndjekin askënd në baza etnike, fetare, por vetëm sipas sjelljeve dhe veprimeve të tyre individuale ose grupore. “Policia e Kosovës nuk është kurrë e drejtuar, e nxitur, e orientuar kundër serbëve. Përkundrazi, ajo ka një konsideratë shtesë për serbët në Kosovë, pikërisht për shkak të keqinterpretimeve të ndryshme, të cilat mund të

bëhen nga fqinji ynë verior”, ka thënë ai para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Megjithatë, Kurti ka thënë se, pavarësisht prej “konsideratës shtesë”, Kosova ka përgjegjësi që dalin nga kushtetuta dhe ligji. “Unë kurrë nuk i barazoj serbët, pavarësisht se çfarë bëjnë e thonë. Beogradi zyrtar e ka kuptuar që nuk po mund t'i ndajë shqiptarët dhe serbët në shpjegimin e situatës në Kosovë. Përditë, serbë dhe

shqiptarë, takohen në Kosovë”.

Ai ka thënë se është duke u konsultuar vazhdimisht me faktorin ndërkombëtar. “Por ju duhet ta kuptoni se ata presin që ne të jemi në nivel të detyrës në vendin tonë. Janë ambasadorët e QUINT-it, por ata nuk bëhen dot ministra. Ministra janë qytetarët e këtij vendi, aktualisht në qeverinë tonë. Qeveritë vijnë e shkojnë, por shteti mbetet”.

Propozimi franko-gjerman 2.0 është si Kosova 2.0



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Oportunizmi si refleks për ta ruajtur pushtetin: I ndjeri Ramush Tahiri, të cilin askush nuk e përmend më, ndonëse ishte njohës i jashtëzakonshëm i historisë shqiptare, që e mbronte pa asnjë mëdyshje identitetin shqiptar përballë një identiteti që ishte legalizuar në Kuvendin e Përgjithshëm të mohuesve të kombit në Gjylekar e që u emërtua si “komb” kosovar sikur që ishte njohës i mirë i politikës, sidomos kësaj në Ballkan, e ka pasur vetëm një të “metë” të vogël, kishte problem t’i priste gjërat e që në terminologjinë politike njihet si oportunizëm, e kishte mendimin e qartë, por nuk donte të konfrontohej me të tjerët në mbrojtje të mendimit edhe në rast se kishte të drejtë 100 %. Në disa shkrime të mëhershme e pata shpallur kampion i oportunizmit. Ramushi më mungon edhe sot sepse kishte nivel të diskutimit krahasuar me nivelin e sotëm ku, një pjesë jo e vogël, e kanë nivelin e baustellës. Pastaj, doli në skenë një politikan shqiptar e jo kosovar, me të kaluar të ndritshme, me një kontribut të madh politik dhe kombëtar, me emër dhe mbiemër të njohur të cilit ia shtoi edhe një mbiemër tjetër që u shndërrua në oportunizist monumental, duke e lënë Ramushin krejtësisht në hije. Tash Ramush Tahiri doli të jetë mikrooportunizist krahasuar me protagonistin e ri të oportunizmit. Nëse prej Ramush Tahirit nuk është pritur të marrë vendime të mëdha sepse nuk ishte vendimmarrës në politikë sikur që nuk kishte asnjë post të vetëm me peshë specifike vendimmarrëse, madje edhe e lanë të papunë duke i premtuar poste e poste, deri te qenit edhe kryetar i Burkina Fasos, prej elefanto-portunistit ishin pritje të mëdha, sidomos nëse mbështetemi në të kaluarën e tij patriotike dhe politike që ishte e pastër si kristali. Me ardhjen e gjeneratave të reja të cilat kapitalin politik e kishin të trashëguar nga paraardhësit, oportunizmi u mbështoll me një mbështjellës që shkoi me kohën, që përkohësisht mbulon lakuriqësinë e

mendimit dhe të veprimtimit e që, edhe në rast kur fryjnë erërat edhe më të buta, këtë lakuriqësi e shndërrojnë në pornografi politike, njerëzore, kombëtare dhe morale që përdoret si kusht për të ardhur në pushtet dhe për ta ruajtur pushtetin me të gjitha mjetet që (s)i lejon imoralitetin njerëzor. Nëse e bëni një skanim, qoftë edhe sipërfaqësor, sepse nuk ka nevojë për një më të thellë, lehtësisht e shihni se në qeverinë Kurti 2 ka të tillë që nuk kanë asnjë të kaluar kombëtare, që nga koha e dinastisë së Nemanjiqëve e deri më sot, se ka urrejtës patologjikë ndaj luftës së Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, se janë urrejtës të papërmbytur të ish-të burgosurve politikë shqiptarë dhe se këtë urrejtje e kanë si vazhdimësi të perit gjenetik që e kanë trashëguar nga paraardhësit e tyre që qençe i kanë shërbyer Titos, Jugosllavisë dhe Serbisë. Në asnjë qeveri të mëparshme, që nga koha e Rrahman Morinës, nuk mund të gjeni urrejtës më të mëdhenj të Jetës dhe Veprës, Kuptimit dhe Përmbyturisë së Luftës për Liri, Çlirim dhe Bashkim Kombëtar, të Amshueshmit Bacë Adem Demaçi.

Propozime dhe propozime: Opinioni në Kosovë që një kohë të gjatë po dhunohet me disa propozime që nuk janë për njohje të Kosovës nga Serbia, por për normalizim të marrëdhënieve të paketuara herë si modeli i dy gjermanive, propozimi i Ishingerit në emër të Trojkës në qendër me rusin Harçenko, propozimi franko-gjerman i cili përditësohet varësisht si reagon Aleksandar Vuçiqi dhe, së fundi, doli një propozim franko-gjerman 2.0, propozim biseksual politik që shitet dhe blihet ashtu si duan propozuesit dhe, nëse do të jetë i përshtatshëm për Serbinë, përfundimisht do të noterizohet nga Aleksandar Vuçiqi. Kryeministri Kurti asnjë propozim nuk i ka gjetur vërejtje për ta refuzuar duke ofruar një qëndrim oportunizist dhe pa parime. Është bazë e mirë për marrëveshje përfundimtare. Deri vonë presidentja Vojsa Osmani nuk ka pranuar se ekziston një propozim i tillë, ndërsa kur dolën duqat nga pampersat e Borrellit, i njohur si Rrahman Morina i Katalonisë dhe Miroslav Lajçak, i njohur si pobratim i Vuçiqit, po kjo presidente thotë se Kosova duhet të bëjë kompromis! Çfarë nuk e thotë, por se vetëm

mund të paramendohen. Glauk bin Sherifi, kryetar i Mexhllisit të Kosovastanit, për të gjitha propozimet ka thënë se janë shumë të mira dhe vetëm një gisht mungon që Serbia ta pranojë pavarësinë e Kosovës, madje këtë e paska pranuar Serbia, por se këtë do ta bëjë publike pas njërit nga dhjetëvjeçarët e ardhshëm. Kjo ma kujton vajtimin e një plake rome që i kishin vlarë djalin diku para 50 vjetëve në Podujevë, ditën e shtunë, që ishte edhe ditë tregu gjatë varrimit: “O azgani i nanës Xhivri, t’kishte shku plumi një gisht mi ballë, nana do të kishte sot të gjallë, he kuku për mu e për Mihrinë që nuk e di qish ka me i rritë fminë...”. Pra, gishtit i nanës Xhivri po përsëritet në gishtin e Glauk bin Sherifit me një dallim se Nëna Xhivri e kishte vuajtjen e shpirtit e Glauku e ka vuajtjen e pushtetit! Ajo me i ruajt mendtë e kokës, kurse Glauku me e ruajt karrigen e b...s. Për koincidencë, vitin e kaluar, kur shkova në Besianë në një kovaçhane për t’i rregulluar do vegla të punës për kopsht dhe oborr, e takova mjeshttrin që përngjante, si të ishte printuar nga fotokopja e gjyshit të vlarë dhe babait që i njihja dhe e pyeta: “a je djali i Filanit dhe a e ke pasur gjyshe Xhivrinë dhe nënë Mihrinë...? Ma pohoi me habi se si i njihja. Mjetet e punës i kishte të njëjta që i kishin pasur babai dhe gjyshi me të cilat kishin mbajtur familjet. Më shkoi mendja te çifutët që janë përpunues të diamanteve në Holandë dhe që mjetet e punës si dhe teknikën e përpunimit i kanë të pandryshuara me qindra vjet. Glauk bin Sherifi foli fjalë edhe më të mira për propozimin e përditësuar me vulën franko-gjermane, me një shtojcë 2.0 sikur që është edhe Kosova 2.0, platformë me përmasa brilante për të drejtat e komunitetit LGBT. Deri më sot nuk më ka rënë të lexoj apo dëgjoj se dikush nga pushteti ta ketë kundërshtuar cilindo propozim franko-gjerman, kurse me entuziazëm duket po e presin ta nënshkruajnë marrëveshjen sipas propozimit franko-gjerman 2.0. Kënaqësia do të ishte edhe më e madhe që kjo marrëveshje të nënshkruhet ditën kur do të votohet Kodi Civil me Kosovën 2.0 në qendër, në vend të njohjes reciproke. Për ndërkombehtarët do të ishte lajm fantastik. Si në Romën e vjetër, kur të gëzohen udhëheqësit, pse mos të gëzohet populli! Memli bin Milazimi, në emër të xhematit që e udhëheq, ka dalë me pesë

ajete negociuese si kusht për arritje të një marrëveshjeje. Nëse i përmbahet deri në fund, nuk do të kundërshtohet nga askush, do të admirohet, nëse kapet pas 2.0, duke e përkrahur edhe ai do të përfundojë në marrëveshje me Kosovën 2.0 në qendër! Lumi i Xhikes nuk po dëgjohej. Në emër të tij po flet Vojsa Osmani. Disi janë ofruar shumë, jo në publik, por “nën hije limoni o me portokalle...”. Pse nuk e bëjnë publik këtë propozim që qenka aq i mirë për Glauk bin Sherifin dhe Albin bin Zaimin dhe e dërgojnë në Bruksel një mashtrues të padijshëm, pa asnjë të kaluar kombëtare dhe politike, që nga dyndja e madhe në krye me Arsenie Çernojeviqin e që, paturpësisht (çka paraqet turpi për të) deklaroi se e di përmbajtjen e propozimit, por nuk guxoj të flas nga Borrelli dhe Lajçaku duke e kontrabanduar si ruajtje të konfidencialitetit për të mos dëmtuar bisedimet! Pse na dëmtton neve dhe ata që kanë lënë asht e rrashtë për këtë vend, nuk paraqet problem. A e kemi merituar që symbyllazi të na fusin në Varkën e Noas, me një drejtues injorant dhe shpirtkeq e të na shëtitin andej-kënde për t’u ankoruar, pas njërit nga dhjetëvjetëshit e ardhshëm në ndonjë port të Serbisë, si federatë apo konfederatë, aspak nuk ka rëndësi!

Kur shpresa vdesë e parafundit: Në veri të Kosovës situata po vlon nga pordhët e Petkoviqit dhe fendët e Vuçiqit. Po flitet për 1 000 policë serbë, me numër identifikues Rezoluta 1244 do t’ia mësyjnë Kosovës. Gjallë Xhela, serbët nuk do të shkelin në Mitrovicën e Jugut. Në Mitrovicën e Veriut le të bëjnë çka të duan, edhe ashtu po e bëjnë. Rada Trajkoviqi, mpreshësja e lapsit të Nenad Rashiqit, urgjentisht po kërkon që policët serbë të kthehen në vendet e punës sepse nuk paska siguri për serbët e Veriut. Kjo Radmilla, ish-kojshikja ime në Podujevë, ose nuk e di ose nuk do ta thotë se policët serbë janë shumë të angazhuar në Veri duke hedhur bomba, duke ua vënë flakën veturave, shtëpive dhe duke gjuajtur me armë të gjata policët shqiptarë, kolegë të deridjeshëm. Kjo Rada po pëson transformim të shpejtë; nga “serbja e Albinit” po i kthehet originës duke u bërë serbe e Vuçiqit... Rada duhet ta ketë të qartë se nuk bëhen dy punë në të njëjtën kohë, edhe me qenë policë të Kosovës, edhe policë të Serbisë, edhe me gjuajtur

bomba, edhe me i ndjekë boshkobuhët (hedhësit e bombave). Rado, llepa Rado...! Do të më kishte kapur paniku patjetër për gjendjen në veri po të mos e shihja patriotin e madh dhe të dëshmuar për bashkim kombëtar me Adem Hodzen, të madhërishmin Alim Rama, me flamurin kombëtar të Kosovapetrolit i shoqëruar nga komandantët e shquar të UÇK-së së Kragujevcit dhe Svetozareves, Teneqe Rati, Mad Mali, Kushtqiu Abazoviqi dhe shumë trima të tjerë që ison ua mbanin Shkurte Pal Vata nga Gërçari i Leskovcit si dhe Humbëse Macolla nga Brusi i Prokupes. Prandaj, jam i sigurt se ende nuk kemi ardhur në situatë të kemi frikë se shpresa vdesë e fundit, në rastin tonë vlen se shpresa vdesë e parafundit, po marrim frymë më lirisht. I kam dy djem që Bacën Adem e thërrisnin gjeneral (vërtet e konsideronin si gjeneral të shpirtit, mendjes, sakrificës dhe patriotizmit), kurse Baca i thërriste ushtarë të tij e që, me eskalimin e situatës, po kërkojnë të mobilizohen për të shkuar në veri. Ua vura vetëm një kusht për t’u dhënë bekimin: Vetëm nëse rreshtohen pas patriotëve të mëdhenj të dëshmuar për patriotizëm, sakrificë dhe vetëflijim; Hekuran Muratit, Dimal Bashës, Haki Abazit dhe shokëve të tyre. Këta do të ishin frymëzim ushtarakë për rekrutët e rinj, kurse si komisarë politikë e kishin kusht t’i nënshtrohen vetëm autoritetit të Besnik Bislimit, askujt tjetër. Thashë, mos përmendni kurrsesi Adem Demaçin, Adem Jasharin, Rexhep Malën, Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin, Ilaz Kodrën, Agim Ramadanin dhe të tjerët se na q... nëna. M’u përgjigjen se asgjë nuk paska mbetur nga patriotizmi im dhe qëndresa në burg, për të cilën i kam gënjyer se ka qenë heroike dhe se, në fakt, as unë e as Baca Adem nuk kemi qenë në burg, por në një hotel në Detin Adriatik, në Kroaci. Po ta pranojnë këtë arsyetim timin, do të pranohen pa asnjë problem në Brigadën e Veriut nën udhëheqje të Veteranit të Vërtetë, Hekuran Murat, nuk do t’u hynte as edhe një therë në këmbë dhe, pas nënshkrimit të marrëveshjeje me Kosova 2.0, në qendër do të kishin një të ardhme të ndritshme. Sikur të gjithë bijtë dhe bijat e spijve që i gëzojnë sot të gjitha privilegjet në regjimin aktual! Vdekje patriotëve dhe luftëtarëve, lavdi të poshtërve dhe tradhtarëve!

Kush po i shërben Ruisë në veri?



Shkruan: Milazim KRASNIQI

Çdo njeri normal e di që veriu i Kosovës de facto është i ndarë nga viti 1999. Ura e Ibrit dhe "Rojat e Urës" kanë qenë simboli

më brutal i ndarjes. U tentua të thyhej ajo bllokadë me protesta e trazira, përfshirë edhe trazirat e dhunshme të vitit 2004, por nuk u shënuar asnjë sukses. Një proces i riintegritimit filloi dhe u avancua deri në njëfarë pike me Procesin e Brukselit, por edhe ai ishte parcial. Atë proces riintegritimi e shkatërroi për dy ditë qeveria Kurti, me vendimin absurd për targat. Ndarja e

veriu sot është edhe më e madhe, se sa në vitin 2008. Fatkeqësisht, sot ka edhe njëfarë mirëkuptimi të faktorëve ndërkombëtar për këtë veprim të ri të serbëve, ngase qeveria Kurti nuk ka marrë para sysh këshillën e SHBA dhe të BE-së. Veprimet e qeverisë me targat ishin veprime të skandaloze. Me atë veprim Kurti i krijoi Serbisë alibi që ta shtyjë përpara

projektin e shkatërrimit a federalizimit të Kosovës. Shpallja e zgjedhjeve në komunat veriore nga Vjosa Osmani ishte xhoker për Serbinë. Gjeti rastin ta konfirmojë në terren ndarjen de fakt të Kosovës. Plagosja e policit do të duhej të ishte vija e kuqe ku qeveria Kurti-Osmani duhet të ndalet e të kërkojë zgjidhje politike. Zgjedhjet duhet të

shtyhen. Nëse nuk ndalon këto lojëra të rrezikshme, qeveria Kurti-Osmani bëhet përgjegjëse për konfliktin që vetëm sa nuk ka eksploduar dhe i cili i konvenon vetëm Ruisë. Serbia po kryen shërbime për Ruisë, sepse është shtet vasal i Ruisë. Po këta qeveritarët tanë, çfarë zori kanë, pse po futen në skemën e Ruisë për ukrainizimin e Kosovës?!

Britania vendos sanksione ndaj Milan Radoiçiqit e Zvonko Veselinoviçit



PRISHTINË, 9 DHJETOR - Britania e Madhe vendosi sanksione ndaj Zvonko Veselinoviçit, Milan Radoiçiqit dhe Slobodan Teshiqit si pjesë e masave të saj globale kundër korrupsionit. Milan Radoiçiq, një biznesmen nga industria e ndërtimit dhe nënkryetar i Listës Serbe, thuhet se "ka përfituar nga përvetësimi i kontratave shtetërore dhe ka përdorur ndikimin e tij për t'u dhënë kontrata fitimprurëse kompanive të tij të ndërtimit". "Zvonko Veselinoviç, biznesmen në industrinë e ndërtimit në Kosovë, shfrytëzon kontratat publike për t'i përvetësuar fondet shtetërore", thuhet në shpjegim. Veselinoviç dhe Radoiçiq janë, gjithashtu, në listën e zezë të ShBA-së për shkak të përfshirjes së tyre në krimin e organizuar

ndërkombëtar dhe autoritetet e Kosovës i lidhin edhe me vrasjen e politikanit të opozitës serbe, Oliver Ivanoviç. "Slobodan Teshiq, një tregtar i njohur armësh nga Serbia, akuzohet për ryshfet ndaj kryeprokurorit të shtetit të një vendi tjetër", thuhet në shpjegim. Teshiq është në listën e sanksioneve amerikane që nga viti 2017 dhe kësaj liste, më 2019, iu shtuan edhe nëntë bashkëpunëtorë të tij. Arsyeja e sanksionimit të tyre ishte tregtia e paligjshme e armëve me disa shtete si dhe dhënia e ryshfetit. Teshiq, gjithashtu, ishte në listën e ndalimit të udhëtimit të Kombeve të Bashkuara nga viti 2003 deri më 2013 për shkak të shkeljes së sanksioneve të OKB-së për eksportet e armëve me

Liberinë. Mediet e lidhën emrin e Teshiqit me kompaninë private të Beogradit "Valir", armët e së cilës ishin në dërgesë prej 11.5 tonësh me armë për në Bangladesh. Në dërgesë ishin përfshirë granata dhe mortaja të ndryshme. Këto armë ishin blerë nga kompania shtetërore e industrisë së armëve "Krushik". Në mesin e pesë të huajve që janë sanksionuar për vepra kundër korrupsionit janë Ilan Shor, kryetar i partisë Shor në Moldavi, i dyshuar për përfshirje në skandalin e mashtrimit në një bankë moldave në vitin 2014, si dhe Vladimir Plahotniuc, një biznesmen dhe ish-politikan i arratisur nga drejtësia moldave, i përfshirë në kapje dhe korrupsion të institucioneve

shtetërore të Moldavisë. "Duke veshur xhepat e tyre me korrupsion dhe vjedhje, aktorët e korrupsionit kanë një efekt korroziv në komunitetet rreth tyre - duke minuar demokracinë dhe duke privuar vendet nga burimet jetike për përfitime të tyre. Si rezultat, mbi 2 për qind e PBB-së globale humbet nga korrupsioni çdo vit", thuhet në postimin e qeverisë britanike. Më 9 dhjetor, ministri i Jashtëm, James Cleverly, njoftoi për masat e ndërmarra si pjesë e një vale të re sanksionesh që synojnë individët e korrupsionit dhe ata që shkelin dhe abuzojnë me të drejtat e njeriut si dhe autorët e dhunës seksuale në konflikte. Sanksionet e së premtes përfshijnë objektiva nga 11 vende në 7 regjime sanksionesh

- që njëherësh janë sanksionet më të shumta që Britania e Madhe ka grumbulluar ndonjëherë në një paketë. Kjo valë sanksionesh, në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, është një kontribut për Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit dhe Ditën e të Drejtave të Njeriut. Në paketën e sanksioneve janë individë dhe subjekte të përfshira në një gamë të gjerë aktivitetsesh serioze - duke përfshirë torturimin e të burgosurve, mobilizimin e trupave për përdhunimin e civilëve dhe mizoritë sistematike. "Këto sanksione tregojnë përkushtimin e Mbretërisë së Bashkuar për t'i mbrojtur shoqëritë e lira dhe të drejtat e njeriut të të gjithëve, kudo", tha qeveria britanike.

Kompanitë e sigurimeve u mundësojnë 450 mijë policë-mbajtësve përdorimin e klauzolës së ndërmjetësimit

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Klauzola e ndërmjetësimit, e cila ka hyrë në funksion të përdorimit në mes të gushtit të këtij viti nga më shumë se 450 mijë policë-mbajtës në vendin tonë, ka filluar të japë efekte pozitive. Kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) të premtën në një tryezë kanë promovuar përfshirjen e klauzolave të ndërmjetësimit në kontratë të sigurimit. Ndërmjetësimi si formë e re e promovuar do ta ulë edhe numrin e madh të lëndëve civile të pazgjidhura, u potencua nga pjesëmarrësit. Aty u tha se rastet e pazgjidhura në gjykata janë paraqitur si shqetësim edhe në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2019. Një ndër rekomandimet kryesore të Komisionit Evropian në fushën e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut është rritja e përpjekjeve nga institucionet e vendit për ta zvogëluar numrin e rasteve të pazgjidhura në gjykata, edhe përmes përdorimit të metodave alternative për zgjidhjen e kontesteve. Sipas drejtorit të BKS-së, Sami

Mazrekut, një ndër metodat më efikase të zgjidhjes alternative të kontesteve e cila mund të përdoret është ndërmjetësimi. “Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë orientim të përgjithshëm për gjykatat e Republikës së Kosovës lidhur me risitë që ka sjellë Ligji për Ndërmjetësim në mënyrë që ato të ndihmohen në identifikimin më të lehtë të lëndëve të përshtatshme për t’u referuar në procedurën e ndërmjetësimit. Ky udhëzues shërben si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për t’u zgjidhur në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm”, ka deklaruar Mazreku. Më tutje, drejtor Mazreku ka bërë me dije se nga ardhja e tij në këtë pozitë kanë arritur t’i mbyllin më shumë se 13 mijë lëndë por, sipas tij, tash e tutje, duke përdorur ndërmjetësimin, synohet të ulët në minimum numri i rasteve të pazgjidhura deri më



tash. Chris Thompson, drejtor i programit “Drejtësia komerciale”, e vlerësoi lart rolin e BKS-së për ndërmjetësim. E kryetarja e Odës së Ndërmjetësuesve, Ganimete Xhelili, ka thënë se si odë e kanë në interes uljen e numrit të lëndëve nëpër gjykata. Me rreth 95 anëtarë sa ka kjo odë, Xhelili ka theksuar se

është në dijeni për mosrespektimin e kontratave që lidhin palët. Po ashtu, edhe Yll Koshi nga kompania e sigurimeve “Scardian” ka thënë se është në interes të kompanive të sigurimeve ndërmjetësimi. “Në praktikë kompanitë e sigurimeve e kanë interesin e ndërmjetësuesve për shkak se e dinë se çka vuajnë nga shpenzimet e

gjykatave dhe nga lëndët e tyre të stërzgjatura”, ka deklaruar ai. Njëjtë sikurse Koshi kanë menduar edhe Arber Ponari nga kompania “Sigal” si dhe Ilir Gaxha nga kompania e sigurimeve “Sigma”. Përfaqësuesit e kompanive të sigurimit kanë thënë se kjo formë e zgjidhjes së shpejtë të lëndëve duhet të promovohet sa më shumë.

KDI-ja: Imunizimi ndaj korrupsionit, parakusht për një shoqëri pa korrupsion

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, KDI-ja ka lansuar kampanjën “Imunizohu kundër korrupsionit”. Kjo kampanjë ka për qëllim sensibilizimin e institucioneve, bizneseve dhe qytetarëve mbi nevojën për të punuar së bashku drejt çrrënjosjes së korrupsionit, që mbetet parakushti kryesor për të bërë përparim në secilën sferë: drejtësi, zhvillim dhe mirëqenie. Simbolikë e këtij aktiviteti është “vaksinimi” kundër korrupsionit, për të treguar vullnetin qytetar dhe institucional se kjo duhet të ndodhë çdo ditë dhe duhet të fillojë me se cilin prej nesh, me familjet tona, institucionet dhe shoqërinë. Përsëri i parë që “u imunizua nga korrupsioni” ishte ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Ndonëse korrupsioni nuk është term i ri për qytetarët, manifestimi i tij shpesh mund të jetë i fshehtë dhe i vështirë për t’u kuptuar. Me këtë rast, KDI-ja ka shpërndarë Abetaren Kundër Korrupsionit - një përmbledhje me shpjegime të thjeshta të koncepteve të korrupsionit. KDI-ja i vlerëson pozitivisht përpjekjet e qeverisë këtë vit



për t’i avancuar ligjet që i shërbejnë parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, duke përfshirë ligje si ai për Agjencinë për Parandalimin e

Korrupsionit, deklarimin e pasurisë, Këshillin Prokurorial, Kodin e Procedurës Penale, financimin politik, Vettingun, apo Byronë për Verifikimin

dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Megjithatë, kanë munguar përpjekjet që në këto diskutime të përçohet një

frymë më bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse me aktorët relevantë. Kjo ka rezultuar me bojkotim të disa prej proceseve nga opozita dhe institucionet e gjyqësorit. KDI vlerëson se pa pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve në iniciativë të rëndësishme ato nuk do të mund të zbatohen dhe nuk do të përbrendësohen si vlera. Zhvillim pozitiv këtë vit është mospërfshirja e zyrtarëve të lartë të qeverisë në skandale të korrupsionit dhe iniciativë të rasteve “Brezovica” dhe “Subvencionet” nga institucionet e drejtësisë. Por, pavarësisht prej sinjaleve pozitive, rastet e korrupsionit të lartë që zvarriten me vite të tëra si, “Hydrocentralet”, “Toka”, “Veteranët”, “Stenta” apo “53 milionëshi”, ende nuk kanë marrë epilog. Në shumë raste korruptive, ku janë të përfshirë zyrtarë të profileve të larta, nuk ka dënime me burgim efektiv. Po ashtu, mungojnë vendimet e institucioneve gjyqësore për konfiskimin e pasurisë së fituar kundërligjshëm. Këto vazhdojnë ta minojnë besimin e publikut në drejtësi, ndërsa në përditshmëri i dekurajojnë qytetarët për t’i raportuar keqpërdorimet.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në letërsi



Prof. dr. Sali BYTYÇI

Hyrje

Letërsia në shekuj ishte ruajtëse e kujtesës, sidomos e asaj për ngjarjet e mëdha siç janë luftërat të cilat tronditin jo një individ, po kolektivitet të tëra njerëzish përgjatë historisë. Për këtë, që në zanafillë të saj, letërsia është e lidhur me luftën. Edhe historia është ruajtëse e kujtesës, po e asaj të jashtme, ndërsa letërsia është ruajtëse e kujtesës së brendshme prandaj, ndër të tjera, edhe për këtë kjo e fundit ka epërsi ndaj historisë.

Çfarë roli ka letërsia në ruajtjen e kujtesës, më së miri do ta kuptojmë kur të lexojmë "Iliadën". Për luftën e Trojës do të mund të mësonim nga mitologjia, nga arkeologjia apo nga piktura, po kurë nga këto nuk do të arrinim të mësonim ato që i mësojmë nga letërsia, në rastin konkret, nga epi i Homerit – "Iliada", prandaj themi lirisht se më meritohet që dimë sot për atë çfarë ndodhi në luftën e Trojës është letërsia. Ndërkaq, çfarë do të ndodhte në botë nëse nuk do të ekzistonte lufta, nëse njerëzit në vend të saj do të zgjidhnin paqen; shkurt, si do të dukesh historia e njerëzimit po të mos ndodhte fenomeni luftë? Për një gjë të tillë vetëm mund të supozojmë, po ajo që dimë është se letërsia do të ishte shumë e varfër, sepse kryeveprat të cilat janë frymëzuar nga lufta nuk do të ekzistonin. Nuk do të ekzistonte as "Iliada", as "Odiseja", as "Eneida", po nuk do të

ekzistonin as shumica e tragjediëve antike të cilat ndërlidhen me luftën e Trojës, nuk do të ekzistonte as komedia e Aristofanit "Paqja", në të cilën gratë bëjnë plane si t'i ndalojnë burrat të mos shkaktajnë luftëra, as romani "Lufta dhe paqja" i Leon Tolstoit, as romanet "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" apo "Kështjella" të Ismail Kadaresë.

Shkurt, nuk do të ekzistonin shumë kryevepra dhe lirisht mund të themi se atë që e humb njerëzimi në luftë, në njëfarë mënyre e kompenson në letërsi.

Për fat të keq, luftërat vazhdojnë të ndodhin edhe në momentin kur po flasim. Një luftë, para dy dekadash, ishte edhe këtu te ne: lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) (1997-1999). Po si u trajtua dhe si trajtohet edhe sot kjo luftë nga shkrimtarët, regjisorët, aktorët shqiptarë, veçanërisht nga ata që e konsiderojnë veten elitë, apo edhe nga "historianët" të huaj?

Në recensionin për romanin e Shefkije Islamajt "Mos më thuaj se më ke parë ëndërr" (2004), të shkruar në vitin 2005, Bedri Zyberaj ankohej se nuk po shkruhen libra për luftën, po tani, 17 vjet pas publikimit të këtij recensionin, si është gjendja në letërsinë shqipe sa i përket kësaj teme? Në fakt, gjendja është e njëjtë, po me përjashtime: janë shkruar libra për luftën e UÇK-së, por jo pak të tilla që janë fokusuar kundër luftës së UÇK-së, pra libra që janë në shërbim të njollosjes së kësaj lufte dhe në një vijë me akuzat e Serbisë ndaj UÇK-së,

të cilat në fund kanë rezultuar me ngritjen dhe aktivizimin e Gjykatës Speciale në Hagë.

Se si lufta, ashtu edhe letërsia ndërlidhen me etiken, autorja e romanit të përmendur më lart, Shefkije Islamaj, e shpreh në vetë faqet e këtij romani, kur thotë se, për të shkruar një roman për luftën nuk duhet vetëm guxim, po edhe dhimbje. Po sa i përket shkrimit të romanit shqiptar për luftën e UÇK-së, guximi e dhimbja mund të jenë pozitive dhe negative: pozitive, kur me dhimbje letërsia i shpreh plagët e luftës, negative kur dhimbja dhe lufta politizohen.

Autorja e romanit Shefkije Islamaj është përfaqësuese e grupit të parë të krijuesve, ndërsa Jusuf Buxhovi i grupit të dytë.

Letërsia e Kosovës (digresion)

Letërsia e Kosovës, e lindur dhe e krijuar në mes të Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë, pas Luftës së Dytë Botërore u krijua si letërsi e realizmit socialist, mirëpo me prishjen e marrëdhënieve të Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik, shkrimtarët e Kosovës, ashtu si dhe ata të Jugosllavisë, s'e kishin të domosdoshme të krijonin sipas doktrinës së realizmit socialist. Megjithatë, edhe rreth dy dekada pas legalizimit të pluralizmit letrar, realizmi socialist, me të gjithë përbërësit e tij, ishte rryma kryesore letrare në letërsinë e Kosovës. Kjo

është e vetëkuptueshme, sepse ata që e kishin nisur krijimin e letërsisë këtu ishin formuar si brez me afinitet për realizmin socialist, ndërkaq brezi pas tyre po krijohet në atmosferën e lirisë krijuese, sipas asaj që kuptonte "liri" krijuese ideologjia zyrtare, pra liri nën mbikëqyrjen e ideologjisë. Ishte pikërisht ky brez që, sidomos pas gjysmës së dytë të viteve '60, pas Plenumit të Brionëve (1966), në të cilin u dënua politika e Rankoviçit në Kosovë, dhe shqiptarët filluan të frymonin më lirshëm, që filloi të krijohet një letërsi me priirje moderne në qendër të së cilës më nuk ishte njeriu po figura, jo konkretja po abstraktja, që zakonisht artikulohej përmes një gjuhe ezopike. Krijuesit tani dolën në një fushë që, ashtu siç ishte abstrakte, nuk kishte fund; fundi mund të prekej vetëm nëse preknin themelet e ideologjisë, po abstraktja në vete nuk prekte asgjë; ideologjia zhvillohej lirshëm, edhe letërsia nën lirinë e ideologjisë zhvillohej, po ashtu, "lirshëm". Ngritja krye kundër realizmit socialist, që shfaqet në këtë kohë, i cili thuhej se burimin e kishte në Shqipëri, kishte dy qëllime: 1. të hiqej dorë nga konkretja; dhe 2. me këtë rast, në emër të abstraktes, letërsia e Kosovës të bëhej pjesë e letërsisë moderne (kupto: zyrtare) jugosllave!

Kjo letërsi moderne zgjati diç më shumë se dy dekada: nga gjysma e dytë e viteve '60e deri në fund të viteve '80.

Pra, ky modernizëm ishte i lidhur me politikën dhe, po ashtu, kur ra poli-

tika, ra edhe ky modernizëm. Tani krijuesit që kishin lëvruar metaforiken dhe simbolikën në krijimtarinë e tyre, i kthehen konkretes, njeriut, fatit të tij konkret në histori dhe në të sotmen. Prozatorë si Zejnullah Rrahmani, Mehmet Kraja, Jusuf Buxhovi etj., në veprat e tyre në prozë: tregime, novela e romane, më nuk qëndrojnë në histori, po i kthehen të sotmes, sidomos zhvillimeve politike të viteve '90. Përveç rrefimit realist, jo trallë tani në veprat e tyre ka edhe personazhe historike, edhe diskursi tani është më shumë konkret, realist e, në ndonjë rast, edhe eseistik, publicistik e politik. Zakonisht në këto vepra personazhet bëhen përcues të ideve të autorëve të tyre, ata mbajnë qëndrim ndaj ngjarjeve historike, po edhe të kohës në të cilën jeton dhe vepron autori i tyre. Në këto vepra vendin e figurës që kishte dominuar më shumë se dy dekada, e zë njeriu, njeriu konkret, ai që në njëfarë mënyre ka luajtur një rol; ky njeri tani bëhet zëdhënës i ideve të autorit apo fati i tij e dëshmon idenë e autorit. Pra, edhe atëherë kur vepra e tij është shkruar në emër të deideologjizimit të shoqërisë, çdo fije në vepër e drejton autori ideologjik!

Kush e shkruan historinë?

Thuhet se, pas luftës, fituesi e shkruan historinë, por një teori e tillë ka përjashtime. Me këtë rast fjalën "histori", e përdor si ekuivalent të fjalës "narracion", në rastin konkret: narracionit për luftën.

Rasti i Kosovës pas luftës së UÇK-së e dëshmon atë që thashë më lart – përjashtimin: humbësit, vija e ashtuquajtur paqësore, e cila për një dekadë nuk arriti të lëvizë as edhe një kashtë përpara në politikën e Kosovës, që dy dekada me radhë e shkruajnë historinë e Kosovës! Në luftë për pushtet, pasi ishte kundër luftës ndaj pushtetit serb, vija humbëse arrin t'i njollosë me çdo mënyrë ata të cilët sakrifkuan edhe jetën për lirinë e Kosovës. Sipas zëdhënësve të kësaj politike në letërsi e histori, Jusuf Buxhovit, Zejnullah Rrahmanit, e të ngjashmëve, në Kosovë ose nuk është bërë luftë fare ose krejt lufta është bërë për t'ia marrë shtetin LDK-së, intelektualëve. Dhe, sipas tyre, shtet ishte ai organizim “paralel” i shqiptarëve nën regjimin e Millosheviqit!

Në fushatën e tyre kundër UÇK-së dhe kundër luftës, këta “intelektualë”, për t'i forcur tezat e tyre kundër luftës, kanë thirrur në ndihmë edhe “intelektualë” të jashtëm, siç është rasti i Oliver J. Shmitit.

Historiani zviceran Oliver J. Shmit, në librin e tij për Kosovën, thotë se lufta e UÇK-së në vitet 1998-1999 është një luftë e fshatarëve kundër intelektualëve. Sipas tij, intelektualët kishin krijuar një shtet paralel në Kosovë, ndërkaq fshatarët ngrihen kundër këtij projekti që nuk po jepte rezultate.

“Për dallim nga intelektualët qytetarë dhe paria e LDK-së, shoqëria fshatare dhe e arsimuar dobët përherë ishte e gatshme për rezistencë të armatosur. Sipas traditës shqiptare, shumica e familjeve në fshatra kishin armë zjarri. Edhe këto familje me vite të tëra kishin respektuar strategjinë paqësore. Por pas Dejonit popullsia fshatare u orientua nga kryengritja e armatosur më shpejt se elita qytetare. Për këtë fshatarët morën ndihmë vendimtare nga diaspora, e cila, ashtu si në vitin 1981, përkrahu një qëndrim më radikal se elita krahinore shqiptare. Në këto rrethana nga mesi i viteve nëntëdhjetë u krijua një lëvizje, e cila në vitet në vijim do të merrte pothuaj gjithë pushtetin në shoqërinë shqiptare të Kosovës – Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Rugova e hetoi rrezikun e konkurrencës dhe grupin gueril në formim e sipër e quajti prodhim të fantazisë, herë mjet provokimi të autoriteteve serbe, të cilat po kërkonin shkas për një aksion të ashpër kundër popullsisë civile shqiptare”. [1] Këtë teori për elitë të vjetër urbane dhe elitë të re fshatare Shmiti e elaboron në vazhdimësi në “trilerin” e vet. [2]

Kështu vjen në përfundim “historiani” Shmit, i cili shoqërinë kosovare e ndan në dy grupe: në intelektualë qytetarë dhe në shoqëri fshatare të arsimuar dobët, sikur këto dy grupe të kenë jetuar në dy realitete të mbyllura, ku as marrin as japin njëri me tjetrin, në një libër të cilit i është kundërpërgjigjur Ibrahim Kelmendi me një libër po aq voluminoz, nëse jo më shumë, “Trileri i O. J. Schmitit për Kosovën”. [3] Mendësisë së Schmitit, i cili me çdo mënyrë përpigjet ta barazojë krimin serb të Millosheviqit ndaj shqiptarëve të Kosovës me krimin e UÇK-së ndaj serbëve dhe

romëve, Ibrahim Kelmendi i përgjigjet: “Fatkeqësisht edhe vetë prof. Schmitt është ‘viktimitë’ e librave ‘historikë’ që me bollëk janë plasuar në treg nga historianët dhe shkencëtarët nacionalistë serbë gjatë shekullit të 19-të dhe 20-të, duke e ngulfatur shkencën e historisë edhe jashtë Serbisë. Ato madje ia kanë dalë të bindin studiues në Evropë e botë dhe kështu ka zënë fill miti i historisë ‘zyrtare’ se Kosova ishte pronësi serbe”. [4]

Në librin e tij “Trileri i O. J. Schmitt për Kosovën”, Ibrahim Kelmendi ka dhënë edhe një mendim se si krijohen historitë e rrejshme për popuj të veçantë, të cilat pastaj, me kalimin e kohës, kthehen në “shkencë” zyrtare, e cila luan rol në diplomacinë ndërkombëtare jo vetëm për ta krijuar imazhin e këtyre popujve, por edhe për ta përcaktuar fatin e tyre: “Duke analizuar rrefimet, vlerësimet dhe konstatimet e z. Schmitt, sidomos për kohën që e kam jetuar unë, po më përforcohet bindja se historitë e popujve edhe mund të falsifikohen. Kur falsifikimet marrin përmasa të mëdha, ato edhe ‘zyrtarizohen’. Me këtë rast, sidomos studentët e prof. Schmittit do të ndihen të detyruar ta lexojnë trilerin e tij historik dhe politik, po edhe të tjerë. Studentët do të bëjnë punime seminari, pastaj punime magjistrature e doktorature për tematikën që ka të bëjë me Kosovën. Ata sigurisht do të citojnë si burime historik edhe këtë triler të z. Schmitt. Edhe kolegët e tjerë, historianë, do t'i ‘pasurojnë’ njohuritë e tyre historike duke lexuar këtë ‘studim’. Kështu me radhë, ‘vëzhguesit neutralë’, gazetarët, analistët, opinionbërësit, politikanët dhe qytetarët, do të krijojnë imazh për Kosovën sipas këtij trileri”. [5]

Këto i thotë për luftën e UÇK-së Schmiti, po çfarë thotë “elita qytetare” kosovare e Schmittit për luftën, sidomos shkrimtarët, si maja ma e lartë e kësaj elite?

Kjo “elitë qytetare”, përveç të tjerash, fjalën e vet për luftën e UÇK-së e tha edhe me pranimin e Schmittit anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në shenjë solidarizimi me të për konkluzionet e tij për këtë luftë.

Se letërsia e Kosovës, apo modernizmi kosovar ishte i ndërlidhur me politikën që në zanafillë, kjo shihet mirë kur ta analizojmë letërsinë që u krijua në Kosovë pas rënies së Murit të Berlinit, sidomos prozën, atë ku krijuesit kanë mundësi më të madhe të shprehjes dhe të vetëshprehjes, me ç'rast, përveç diskursit letrar (trillimit), përdorin edhe diskurse të tjera.

Mohimi i luftës së UÇK-së

Eksponent i grupit të parë është Zejnullah Rrahmani, i cili e ka thënë “fjalën” e vet për ngjarjet e vitit 1981 apo për vrasjen e Jusuf Gërvallës, vlerësime që përputhen me vlerësimet zyrtare serbe e jugosllave, po që shkojnë edhe përtej tyre, për luftën e UÇK-së të viteve '97-'99 vetëm në intervistën në revistën “Fjala”, ku prononcohet nëpërmjet personazhit të nënës së vet: “Tash nëna është më e vjetër se ai (e ka fjalën për babanë e vet – vër. ime, S.Bytyçi) dhe e ka përvojën edhe të



një lufte. ‘Çfarë lufte asht kjo që nuk më ra me pa asnjë shqiptar tue shkrepë një plum po veç tue ikë?’ [6] Kaq shprehet për ngjarjet '97-'99 dhe me kaq e përmbyll këtë çështje Zejnullah Rrahmani.

Ndërsa unë s'do të hyja më thellë në këtë temë, po një gjë e di: sa isha në burg në Serbi, në vitet 1999-2000, në shtypin serb kam lexuar për një libër të botuar serbisht me titull “Heroji otadzbine” (Heronjtë e atdheut), në të cilin janë të shënuar mbi një mijë policë e ushtarë të vrarë në Kosovë në luftimet e zhvilluara në vitet '98-'99. Gazeta “Danas” e Beogradit çdo ditë i jepte nga tri biografi të të vrarëve në Kosovë e më gjerë, ku për secilin shkruante, në mes të tjerash, vendin, datën dhe nga kush është vrarë (nga “terroristët” shqiptarë, siç i quante pjesëtarët e UÇK-së, apo nga NATO).

Pohimi i luftës së UÇK-së

Ndryshe nga Zejnullah Rrahmani ndodh me Zuvdija Hoxhiqin, shkrimtar malazez me prejardhje shqiptare, i cili nuk shkruan në gjuhën e të parëve, po shkruan në gjuhën e shtetit në të cilin i ka rënë fati të jetojë, pas copëtimit të trojeve shqiptare në dekadat e fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në romanin e tij të fundit, “Të gjithë njerëzit e mi”, roman autobiografik, shkrimtari Zuvdija Hoxhiq shkruan për ngjarje të së kaluarës, të kohës kur shqiptarët ishin bashkë nën Perandorinë Osmane, po edhe më tej, pas largimit të Perandorisë Osmane.

Pas ngjarjeve tragjike të Bosnjë-Hercegovinës, një pjesë të këtij romani ia kushton edhe Kosovës, përkatësisht luftës së UÇK-së për çlirimin e Kosovës. Në këtë luftë, vajza e tezës së tij, Shefka, “ka bërë betimin në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ka kaluar stërvitjen, ka marrë pjesë në përlëshjet me forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe, ka luftuar rreptësisht, pa mëshirë, ndaj armikut ashtu si ai ndaj popullatës shqiptare. Ushtarët kanë vrarë të pafajshmit, kanë djegur shtëpitë, dorëshkrimet e vjetra shekullore dhe me vlerë. Pa frikë dhe me guxim është vënë si udhëheqëse e çetës ‘Baba Faja Martaneshi’”. [7] Kjo vajzë, së cilës shokët e luftës ia vënë emrin e Shotë Galicës, vritet në

Junik, duke u bërë kështu dëshmitare dhe dëshmore njëherësh e një lufte të pabarabartë për çlirim.

Shkrimi si terapi për shërimin e ndërgjegjes së vrarë

Në shtetet ideologjike, siç ishte edhe ish-Jugosllavia, krijuesit i paguanin tagër ideologjisë, sidomos ata që ishin më ambiciozë. Njëri prej tyre ishte Jusuf Buxhovi, i cili që në vitet '70 dërgohet korrespondenti gazetës së përditshme të Kosovës “Rilindja” në kryeqytetin e Republikës Federale të Gjermanisë, Bon.

Se kush dërgohej si “korrespondent” në qytetet e kryesore të Evropës dhe në ShBA, kjo pak a shumë dihet: të besueshmit e regjimit. Të shërbyerit regjimit ideologjik (kupto: në dëm të popullit të vet), lë plagë në ndërgjegjen e krijuesit, plagë që më vonë ky krijues synon t'i shërojë. Këtë synon ta bëjë në vazhdimësi Jusuf Buxhovi, i cili krijimin e letërsisë, dhe jo vetëm të letërsisë, por shkrimin “historik”, intervistat e ndryshme, atë publicistik etj, e përdor si një lloj terapie për shërimin e ndërgjegjes së vet të plagosur.

Si ish-agjent i UDB-së, gjë që tërthorazi e ka pohuar jo vetëm në një rast, në çdo shkrim të tij i krijon rrethanat e tilla që veten ta nxjerrë në anën e duhur të historisë, me ç'rast lexuesi, për çdo periudhë nëpër të cilën ka kaluar, bazuar në shkrimet e tij, mund të nxjerrë shembuj të cilët Jusuf Buxhovin e nxjerrin në anën e ndritshme të historisë.

Këtë shkrim – shkrimin si terapi për ta shëruar ndërgjegjen e vrarë – Buxhovi e ka nisur para rënies së Murit të Berlinit, me romanin “Libri i të mallkuarve” (“Rilindja”, Prishtinë, 1989), por në këtë roman ende zotëron poetika e romanit simbolik-alegorik, ndërkaq e ka vazhduar më pas thuasë me të gjitha romanet, që nga “Prapë vdekja” e deri te “Dosja B”, tek i cili do të ndalemi më gjatë.

Kohën e rrefimit në romanin e fundit e çon deri te përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, po më së shumti ndalet në zhvillimet e viteve '70e tutje, kohë në të cilën Buxhovi dërgohet “korrespondent” i gazetës

“Rilindja” në kryeqytetin e Gjermanisë Federale, Bon. Për këtë kohë, dhe atë më pas, është i specializuar se, siç duket, atje ishte dërguar jo që ta përcjellë jetën kulturore të emigrantëve shqiptarë si dhe zhvillimet në Gjermaninë federale, po pikërisht për ta përcjellë veprimtarinë e emigrantëve politikë shqiptarë. Dhe gjithë atë “dije” të përfituar gjatë asaj kohe e derdh në romanin e tij “Dosja B”, dhe jo vetëm në të.

Lufta në mes të të kundërtave, të cilat i jep në romanin e tij, është shprehur si një luftë në mes të së mirës dhe të së keqes. Në këtë ndeshje autori gjithnjë është në anën e së mirës.

Sipas Jusuf Buxhovit, lufta e grupeve shqiptare kundër Jugosllavisë, në vitet '70, ka qenë e sponsoruar nga KGB-ja ruse dhe Sigurimi shqiptar si pjesë e KGB-së.

Cili ishte qëllimi i këtyre grupeve shqiptare që luftojnë kundër vetëqeverisjes jugosllave? Sipas Buxhovit, qëllimi ishte që të nxiteshin konfliktet në Jugosllavi, të cilat, pas vdekjes së Titos, Bashkimi Sovjetik do t'i përdorte si pretekst për të ndërhyrë në Jugosllavi dhe për ta kthyer Jugosllavinë nën Paktin e Varshavës! Dhe, në këtë kontekst, luftimi i këtyre grupeve nga UDB-a, pjesë e së cilës ishte edhe Buxhovi, është legjitimë, sepse kjo bëhet që Jugosllavia të mos kthehej nën Paktin e Varshavës, një gjë e tillë është edhe në interes të NATO-s, që Pakti i Varshavës të mos zgjerohet! Buxhovi i përket anës që e lufton këtë lëvizje klandestine shqiptare në Perëndim, edhe pse është pjesëtar i kombit shqiptar, prandaj me këtë e shëron ndërgjegjen e vet, se ka bërë një luftë të drejtë! Marrë globalisht, përtej interesave të ngushta nacionale, si të mos jetë në anën e drejtë kur ishte në anën e atyre që e kanë luftuar zgjerimin e Paktit të Varshavës?! Dhe se, në fund të fundit, dobësimi i Paktit të Varshavës është edhe në interes të kombit të tij?

Për demonstratat e rinisë studentore dhe të popullit shqiptar të vitit 1981, inteligjencia zyrtare e Kosovës, shumica, e edhe Buxhovi, kishte pranuar kualifikimin zyrtar të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë e Jugosllavisë si “kundërrevolucion”! Pra, tetë vjet para rënies së Murit të Berlinit, kjo inteligjenci, e bashkë me

të edhe Jusuf Buxhovi, kishte qenë revolucionare, e majtë, ndërkaq tani, me rënin e Murit të Berlinit, na kthehet në inteligjenci patriotike intelektuale, e djathtë, si pasardhëse e Nacional-Demokratës shqiptare! E “kundërrevolucionarët” tani janë “revolucionarë”, janë ideologjikë, janë njerëz që duan ta kthejnë shtetin institucional në shtet ideologjik!

Për Buxhovin, në vazhdimësi, të gjithë ata që luftojnë kundër regjimit jugosllav janë njerëz ose të shtyrë nga shërbimet e huaja inteligjente, ose janë kriminelë të lindur të cilët, kinse, përmes luftës atdhetare, zhvillojnë veprimtari kriminale, ndërsa ata që i përndjekin këta, janë faqja tjetër, ajo e ndritshmja, pjesë e së cilës është ky në çdo kohë! Pra historia zhvillohet bardh e zi, ndërsa Buxhovi gjithnjë qëndron në anën e bardhë. Ky është qëllimi i krijimit të letrare dhe historike të Buxhovit, me ç'rast veprat (pseudo)letrare kanë faqe të tëra të diskutit (pseudo)historik!

Ndryshe nga Zejnullah Rrahmani, Jusuf Buxhovi e pranon që në vitet 1998-1999 në Kosovë ka pasur luftë, po çështja është çfarë lufte kishte në Kosovë?

Këtë ka qëllim ta tregojë në romanin “Dosja B”.

Në romanin “Dosja B”, në të cilin Buxhovi fokusohet kryesisht nga ngjarjet e vitit 1997, pas rënies së firmave piramidale në Shqipëri e deri në vitet e pasluftës në Kosovë, ngjarjet lëvizin sidomos në pjesët e Kosovës ku ishte organizuar lufta e UÇK-së, duke u nisur nga zona e Nerodimes, Shtimja, Malisheva e deri në Prizren, në anën e majtë të Drinit, për të kaluar në anën tjetër, në

Dushkajë, ndërsa përfundojnë në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në Drenicë, për t'u rishfaqur pas luftës përmes Rojës së Burgut dhe Vrasësit të Penduar.

Në këtë roman së pari bëhet barazimi në mes të UÇK-së dhe të forcave ushtarake e policore serbe, por Jusuf Buxhovit nuk i mjafton kjo gjë dhe shkon më tej duke mos i mjaftuar barazimi: theksi këtu bie mbi krimet e UÇK-së, veçanërisht ndaj popullit shqiptar, rrallë edhe ndaj ndonjë serbi, siç është rasti i burgosjes së një postieri nga Drenica, i cili është dashamir ndaj shqiptarëve, saqë krimet serbe bien në hije nga krimet që ka kryer UÇK-ja!

Subjekti i romanit nis nga Lufta e Dytë Botërore, po fokusi i autorit është në zhvillimet nga vitet '90e tutje, kur bie ideologjia komuniste, kur intelektualët kosovarë, siç thotë jo vetëm një herë në roman, sidomos ata të “Rilindjes”, krijojnë LDK-në, e cila, sipas autorit, është lëvizje kombëtare, që rrënjët i ka te Nacional-demokratja shqiptare, ndërkaq LPK-ja është trashëguese e ideologjisë komuniste!

Si ndodhi kjo alkimi, çfarë shndërrimesh kanë ndodhur në botën shqiptare, në fund të viteve '80, kur bie komunizmi dhe shteti jugosllav legalizon pluralizmin politik, me ç'rast regjistrojnë një parti politike, që do të veprojë sipas kornizës ligjore serbe e jugosllave, një mendje e shëndoshë e ka të vështirë ta kuptojë!

Është fakt historik se Nacional-demokratja shqiptare, pas Luftës së Dytë Botërore, është luftuar dhe asgjësuar nga komunistët, të cilët e

morën pushtetin nga viti 1944 e deri në vitin 1989, pjesë e të cilëve ishte edhe inteligjencia që krijoi LDK-në, ndërkaq, nga Jusuf Buxhovi, me një të rënë të lapsit, të gjithë komunistët e Kosovës që kanë qenë në pushtet nga viti 1945 e deri më 1989 tani bëhen trashëgues të Nacional-demokrates shqiptare, dhe të gjithë kundërshtarët e komunistëve, shumica prej të cilëve të burgosur politikë përgjatë kësaj kohe, bëhen trashëgues të komunistëve! Se si bëhet kjo lidhje e këtyre intelektualëve komunistë me Nacional-demokraten shqiptare, të dënuar 45 vjet më parë, shumica prej të cilëve as të lindur nuk ishin kur u dënua Nacional-demokratja shqiptare; njerëz të cilët gjatë gjithë jetës së tyre ishin të nënshtruarit e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, këtë nuk na e thotë askund Jusuf Buxhovi!

Letërsia moderne, përkundër asaj të realizmit socialist, e tejkalon skemën e ndarjes së botës në bardh e zi. Letërsia e Kosovës, si letërsi moderne, pretendon se e ka tejkalar këtë skemë, sidomos nga gjysma e dytë e viteve '60e tutje, po Jusuf Buxhovi më shumë se tri dekada që është kthyer në këtë skemë, në bazë të së cilës i thur krijimet e veta.

Skemën bardh e zi, jo vetëm përmes ngjarjeve, përmes konfliktit në mes të personazheve negativë e pozitivë, përmes ideve, jo rrallë Jusuf Buxhovi në romanin e tij e jep direkt, tamam sikurse në librat sociologjikë apo edhe psikologjikë. Citoj: “...konfliktin e thellë të kahershëm shoqëror dhe politik midis dy rrymave: asaj intelektuale dhe

ideologjike, të cilat shkatërrimi i ish-Jugosllavisë si dhe konfliktet e shpërthyer me atë rast i kishte vu përpara përgjegjësisë historike që t'i jepej përgjigje ardhmërisë në rrethanat e reja tepër të turbullta ku opsonet çfarëdo qofshin pashmangshëm përkufizohen me limitet e gjeostrategjisë dhe ato të gjeopolitikës, që duhej njohtë dhe kuptuar për të mos u shpërputhur me to”.[8]

Po i njëjti diskurs sociologjik zhvillohet në më shumë se gjysmën e vëllimit të këtij romanit: “Natyrisht se në këtë përvijim tepër të rëndësishëm, rryma intelektuale me përkushtim patriotik, kishte qenë e drejtpërdrejtë në të dy planet (atë gjeostrategjik – në binarët perëndimorë dhe gjeopolitikë – në binarët e parlamentarizmit demokratik), mbi të cilën ishte mbështetur edhe platforma e lëvizjes institucionale (shteti i pavarur i Kosovës, që si parakusht kishte shkëputjen e lidhjeve me Serbinë)”.[9]

Buxhovi, që më parë e ka në kokë atë që do të thotë. E ka hartën në të cilët lëvizin personazhet e tij, e ka edhe kohën, dhe ky i drejton ata në këtë kohë dhe hapësirë. Në të vërtetë, Jusuf Buxhovi ka më shumë se tri dekada, që i lëviz personazhet në bazë të ideve që ka që më parë në mendje. Siç kuptohet nga citatet, në këtë roman të tij bota shqiptare është e ndarë në dysh: në patriotë dhe në ideologë; në luftëtarë të lëvizjes kombëtare dhe në revolucionarë ideologjikë; në intelektualë dhe jointelektualë.

Shumicën e veprave romanore Buxhovi i ka krijuar për ta arsytuar

rugën të cilën e kishte marr që i ri. Dallimi tani është në atë se, në vitet '80 fshihej pas metaforikes e simbolikës, fshihej pas aluzioneve etj., ndërkaq pas rënies së Murit të Berlinit, në veprën e tij ideologjike (gjithë kohën bën luftë ideologjike) stigmatizon ideologjinë kundërshtarë, kinse nga pozita e intelektualit të deideologjizuar!

Romani për pasojat e luftës

Nga pikëshikimi i kundërt prej Jusuf Buxhovit e Zejnullah Rrahmanit, temën e luftës së UÇK-së e trajton Shefkije Islamaj.

Lufta në mes palëve të ndryshme, si kohë, gjithnjë është më e shkurtër se pasojat që lë lufta prapa. Romani i Shefkije Islamajt, “Mos më thuaj se më ke parë ëndërr”, sipas Bedri Zyberajt, nuk është fokusuar në dhënien e drejtpërdrejt të luftës, po “më shumë në pasojat e saj, e më pak në vetë atë, si fenomen real”.[10]

Dhënia e luftës jo direkt, po sipas pasojave që sjell ajo, në letërsinë shqipe është e njohur me romanin e Ismail Kadaresë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, edhe pse këto dy vepra janë të ndryshme mes tyre.

Narratorja e romanit dhe protagonistja në të njëjtën kohë, është një mjekë, ginekologe, e cila do të shkruajë një roman për kohën në të cilën njerëzit donin ta zhbënin njëri-tjetrin.

Në këtë roman është dhënë ana e jashtme e luftës, si vrasjet, djegiet, dhunimet etj., po narratorja më shumë fokusohet te bota e brendshme e personazheve, te fati i



tyre në luftë, te përjetimet e tyre, te plagët që i marrin këto personazhe. Luftën e jep përmes fatit të një vajze 18-vjeçare, Butës, e cila ishte përdhunuar nga forcat serbe gjatë depërtimit masiv të popullsisë shqiptare në Shqipëri dhe, si pasojë e këtij përdhunimi, kishte ngelur shtatzënë.

Pra, pasojat e luftës nuk ndodhin vetëm për kohën sa zgjat lufta, por edhe pas saj. Shtatzënia e Butës, lë të kuptohet se, ashtu siç e bart Butja në barkun e saj frytin e dhunimit, njeriu që ka përjetuar luftën, pasojat e saj do t'i bartë edhe më tej. Ky njeri për një kohë të gjatë, disa edhe deri në vdekje, do të jetojë me pasojat e luftës.

Si të sillt Butja ndaj këtij "fryti" të dhunimit, të jetojë me të dhe kështu të mbijetojë, apo të përfundojë bashkë me të?

Pra, autorja në romanin e saj ka trajtuar një temë që përshkohet përmes etikës dhe ekzistencialës: Si të sillt njeriu ndaj frytit të përdhunimit, kur ky fryt është bërë pjesë e tij?

Dhënia e luftës përmes fatit të femrës në luftë, e bën më të ndjeshme këtë temë. Po të ishte mashkull Butja, do të përfundonte me një plumb pas kokës dhe, me këtë dhimbje të madhe, do të përfundonin edhe dhimbjet e saj njëherë e përgjithmonë, ndërkaq, si femër, nuk vritet me plumb, por "vritet" përmes përdhunimit, vrasje të cilën edhe për një kohë do ta bartë me vete e në vete në jetën e saj. Fundi i luftës për të gjithë të tjerët nuk shënon edhe fundin e luftës për të dhunuarën, sepse ajo tani është në një luftë të re jo vetëm me dilemat e saj, por edhe me mentalitetin e shoqërisë cila nuk e gjykon veten pse nuk mundi ta mbrojë atë nga dhunimi, po e gjykon të dhunuarën! Një qëndrim i tillë ndaj të dhunuarës nga forcat serbe do të thotë përsëritje e dhunimit tani në rrethana të tjera. Në pamundësi ta përballojë këtë dhunim të dytë, Butja bën vetëvrasje. "Mirëpo, motivi i vetëvrasjes së Butës në romanin 'Mos më thuj...' është diçka më shumë sesa shënjeshtë e thjeshtë i rrjedhobjave të luftës, i vuajtjeve dhe pësimeve të saj".[11]

Butja bën vetëvrasje sepse ajo nuk mund ta durojë dyfytërsinë e shoqërisë në të cilën jeton, nuk mund ta durojë gjykimin që bën kjo shoqëri ndaj saj. Po vrasjet dhe vetëvrasjet e atyre që kanë përjetuar luftën kanë vazhduar deri në ditën e sotme, ndërkaq, vrasja e tillë që u bëhet pjesëtarëve të luftës, luftëtarëve të UÇK-së, është edhe stigmatizimi i tyre në veprat e disa prej prozatorëve kosovarë, ku më i dalluari mes tyre është Jusuf Buxhovi.

Emërtimi si shprehje e thelbit të luftës

Në tregimin e gjatë "Varret pa të vdekur, të vdekurit pa varre", të Bedri Zyberajt, përmes dialogut që bëjnë komandanti serb me vozitësin e vet, përpiqet të depërtojë në fenomenin e luftës.

Ky dialog ndodh pesë ditë pas një masakre në të cilën forcat serbe vranë 106 shqiptarë. Pasi në këtë masakër është vranë biri i saj, një plakë çdo ditë më gjatë tërë ditës

pranë varrit të tij; vozitësi do ta vrasë plakën, po komandanti e ndalon. Të nesërmen, kur komandanti dhe shoferi i tij e vizitojnë vendin e kryerjes së masakrës, prapë e shohin plakën që qëndron pranë varrit të të birit, indiferent ndaj pranisë së njerëzve që kanë kryer masakrën. Këtu fillon dialogu në mes vozitësit dhe eprorit të tij: përse eprori nuk i jep leje ta vrasë atë plakë, ngase i dhimbset? Gjatë bisedës kuptohet pse-ja e këtij veprimi. Eprori e ka përvojën e paraardhësit të tij, të gjyshit i cili në fillim të shekullit kishte marrë pjesë në pushtimin e tokave shqiptare, prandaj edhe ka krijuar filozofinë se si duhet të bëhet spastrimi i këtyre tokave nga banorët e saj.

Kujtesa: 80 vjet më parë gjyshi i këtij eprori serb ka marrë pjesë në vrasjen e 30 shqiptarëve, në fshatin tjetër pas bjeshke; pra janë masakrat që lidhin të djeshmen me të sotmen.

Në këtë tregim, përmes atyre që bëjnë luftë kundër vendorëve, shpërfaqet edhe kundërshtia: ne – ata. Sipas eprorit, serbët sikur edhe popujt e civilizuar, luftën e bëjnë mend, ndërkaq shqiptarët me zemër, prandaj këta të fundit edhe janë më të dobët në luftë.

Ndër të tjera, këta përsiatin edhe për emërtimin e luftës, i cili reflekton edhe në karakterin e luftës: emërtimi i luftës sipas emrit të njerëzve, si lufta e Sadik Ramës apo e Azem Bejtës, lufta e Shaban Polluzhës, dje, tregon luftën e karakterit lokal që lidhet me një krahinë, ndërkaq emërtimi i kësaj të fundit që po bëhej tani si lufta e UÇK-së, tregon karakterin mbikrahinor apo karakterin kombëtar të saj, sepse kjo luftë nuk është e lidhur me një krahinë apo me persona të veçantë, po me një komb. "Ne mund të çlirohemi nga kjo farë e keqe vetëm duke ua shtuar vuajtjet e jo varret. Një varr më tepër, një lidhje më shumë është për ta me këtë tokë".[12] Ky është konkluzioni në të cilin ka ardhur komandanti i ushtrisë serbe, prandaj dhe kishte urdhëruar që plaka të mos vritej nga shoqëruesi i tij.

Trillimi letrar dhe trillimi "historik"

Që në zanafillë të krijimit të saj, përmes trillimit në letërsi artikulohe në të vërtetë të përgjithshme e universale për të qenët e njeriut në botë, të vërteta me të cilat njeriu përballet përherë (të kujtojmë Epin e Gilgameshit); jo për të vërtetë të pjeshme, me të cilat merret historia; ndaj themi se trillimi e shpreh natyrën e letërsisë, dhe është pikërisht ai që e dallon letërsinë nga historia.

Sipas Aristotelit, natyra e poezisë nuk qëndron te forma, po te përmbajtja e saj. Sipas tij, edhe vepra e Herodotit do të mund të kthehej në vargje, po ajo prapë nuk do të ishte letërsi, sepse ajo e thotë atë që ka ndodhur, ndërkaq vepra letrare e thotë "atë që mund të shpresohet që do të ndodhë".[13] Për ta saktësuar më tej përse poezia është më filozofike se historia: "poezia tregon më tepër gjëra të përgjithshme, kurse historia gjëra të veçanta".[14]

E vërteta e letërsisë qëndron në trillimin letrar, në atë trillim në

brendinë e të cilit fshihen të vërtetë të përherëshme të të qenit të njeriut në botë, për vuajtjet dhe ëndërrimet e këtij njeriu, për përpjekjet që ta tejkalojë vetveten. Si shembull marrim trillimin në romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" të Ismail Kadare: prapa një rëfimi të trilluar për zhvarrimin e ushtarëve italianë në Shqipëri, 20 vjet pas Luftës së Dytë Botërore, kur Italia fashiste detyrimisht kishte pushtuar Shqipërinë, e vërtetë e këtij trillimi është se luftërat pushtuese, pa marrë parasysh sa të fuqishëm që të jenë ata që i bëjnë, në fund dështojnë.

Një tjetër trillim, i kundërt me të parin, është trillimi "historik", trillim që synon të kthehet në të vërtetë historike, si njëfarë keqpërdorimi i të parit, kur autori përmes këtij trillimi nuk synon të vërtetë të përgjithshme, universale, po të vërtetë të veçanta, të pjeshme, shkurt, shkruan histori (të njëanshme), të cilat i shoqëron me ngjarje dhe personazhe.

Përfaqësues i një trillimi të tillë në Kosovë është Jusuf Buxhovi: "letërsia" e Jusuf Buxhovit, e krijuar me një gjuhë më shumë "dokumentare" publicistike, nuk ka për synim zbulimin e të vërtetave të përgjithshme dhe universale të të ekzistuarit të njeriut, po të vërtetë parciale, të veçanta, që lidhen me një kontekst kohor të caktuar, jo përmes një konteksti të shkollës drejt dekontekstualizimit, po të mbetet në vetë kontekstin për të cilin rëfem; jo të vërtetë të përgjithshme, po për të vërtetë të veçanta.

Në krijimtarinë letrare të Jusuf Buxhovit, Zejnallah Rrahmanit etj., bëhet kthimi i skemës bardh e zi në letërsinë shqipe, trillimi letrar vihet në shërbim të të veçantës dhe, në fund, lexuesi nuk përjeton katarsis, përkundrazi, përjeton mllaf dhe dëshirë për hakmarije ndaj të gjithë atyre të cilët këta krijues i pasqyrojnë me ngjyra të errëta; pra lexuesi ndien se, me përfundimin e romanit lufta nuk ka përfunduar, por sapo ka filluar dhe mbush lexuesin me urrejtje dhe revoltë ndaj së keqes të personifikuar të personazhet negative, të cilët kanë ngadhënjyer. Një trillim i tillë nuk synon të rrëfejë për ngjarje që mund të shpresohet që do të ndodhin, por për ngjarje që kanë ndodhur. Proza e këtyre krijuesve është më afër historisë (historisë së trilluar) sesa letërsisë. Ndodhitë e prozave të tyre, pa marrë parasysh formën që kanë, pra që janë të krijuara me personazhe e dialogë personazhesh, më afër janë me historinë sesa me letërsinë. Zaten, ky ishte edhe qëllimi i autorëve të këtyre prozave: të tregojnë të vërtetën për ngjarje të caktuara. Ndoshta edhe për këtë arsye, lexuesi i këtyre veprave në prozë, në fund të leximit të tyre nuk pëson katarsë, nuk shkarkohet nga emocionet që shkaktohen nga ngjarjet tragjike, po, përkundrazi, mbushen me emocione: në rastin konkret – me mllaf, i cili shkaktohet nga padrejtësia që i bën njëra palë – keqja, palës tjetër – të mirës.

Përfundim

Lufta e UÇK-së jo vetëm që nuk ka zënë vendin e merituar në letërsinë shqipe pas përfundimit të saj në

qershor të vitit 1999 kur, me ndihmën e NATO-s, regjimi shtypës i Millosheviqit së bashku me makinerinë e tij u detyrua të lëshonte Kosovën, po kjo luftë në letërsi edhe është stigmatizuar, duke i dhënë ngjyra kriminale, nga shkrimtarë të cilët karrierën e tyre e kanë krijuar në Jugosllavinë socialiste, para rënies së Murit të Berlinit.

Sa i përket kësaj lufte, në librat e tyre, disa prej shkrimtarëve shqiptarë të cilët karrierën e vet e bënë në atë kohë, ose e mohojnë ose e kriminalizojnë, duke i atribuuar udhëheqjes së kësaj lufte cilësitë e një grupi të kriminalizuar, i cili nuk kishte synime atdhetare, po ideologjike.

Gjatë gjithë kohës Buxhovi, në romanin "Dosja B", konfliktin brendashqiptar e kualifikon si konflikt i vjetër shoqëror në mes të dy rrymave: rrymës intelektuale dhe asaj ideologjike. Të dyja këto rryma, sipas tij, janë të pastra, pa asnjë cilësi tjetër: ata që janë intelektuale, në tërë qenien e tyre janë intelektuale; ata që janë ideologjike, janë tërësisht qenie ideologjike. Asnjë raport nuk ekziston në mes tyre, përveç përplasjes, e cila burimin e ka te rryma ideologjike, që nuk i zgjedh mjetet për ta arritur ngadhënjimin ndaj rrymës intelektuale. Kur bëhet ndeshja në mes të rrymës intelektuale dhe asaj ideologjike, dihet që më parë ngadhënjyesi: ai që nuk i zgjedh mjetet për ta arritur fitoren, pra rryma ideologjike, e cila mbështetjen e ka te rrymat ideologjike ndërkombëtare, ndërkaq rryma intelektuale te intelektualiteti i vet, prandaj, ndër të tjera, e para ka përparësi ndaj së dytës.

Sa i përket luftës në letërsi, gjithë ajo luftë bëhet në "Iliadë", gjithë ata heronj vriten, gjithë ato tmerre ndodhin, po askund Homeri nuk merr anë; për të, të gjithë janë heronj, asnjëri prej tyre nuk është përgjegjës për luftën, për të cilën fajin e kanë zotat; pra të dyja palët janë të barabarta, edhe përfundimi i luftës është në dorën e vet zotave të Olimp!t

Ndërkaq, sa i përket luftës së UÇK-së, edhe pse inteligjencia shqiptare do të duhej të merrte anë, pra ta përkrahte popullin e vet, ta përkrahte të drejtën e këtij populli për të jetuar i lirë, po t'i përkrahte edhe ata që bënë luftën mbrojtëse, çështja qëndron ndryshe: jo vetëm bashkësia ndërkombëtare, me krijimin e Gjykatës Speciale në Hagë në të cilën gjykohen vetëm shqiptarët, po edhe një pjesë e inteligjencës shqiptare, që e emërton veten "elitë", e cila me rënien e Murit të Berlinit, kur u legalizua pluralizmi politik, kishte krijuar një lëvizje paqësore përmes së cilës bënte përpjekje ta zgjidhte çështjen e Kosovës, po që në fund të një dekade të kësaj lëvizjeje rezultatet ishin baras me zero – shkrimtarë, profesorë, aktorë e regjisorë, të motivuar politikisht, në qëndrimin ndaj luftës së UÇK-së ishin dhe vazhdojnë të jenë të njëanshëm! Pra, atë që nuk e bëri Homeri para më shumë se tremijë vjetësh, e bëjnë sot këta heronj shqiptarë të kohës sonë! Si zakonisht në veprat e tyre letrare apo filmike, sa i përket luftës së UÇK-së, këta, duke zbuluar "fajtorin", që është


gjuhnjë tek ata që e bënë luftën, para lexuesit apo shikuesit, nuk e ruajnë paanësinë sa i përket luftës në mes të dyja anëve të kundërta: UÇK-së dhe forcave policore e ushtarake serbe! Nëse vargu i parë i "Iliadës" nis me mëninë e Akil Pelidit për vrasjen e mikut të vet nga Hektori, epika e këtyre pseudo-shkrimtarëve-elitë nuk i këndon mënisë së UÇK-së ndaj forcave policore dhe ushtarake serbe, po mënisë së vet këtyre pseudo-intelektualëve ndaj luftës së UÇK-së! Dhe, nëse me veprën e tyre moderne, moderniste e ultra-moderniste kurrë nuk arritën të dalin në Evropë, dëshirë e tyre e kamotshme, tani këtyre super-krijuesve u erdhi rasti të shkojnë atje së paku si dëshmitarë të Gjykatës së Hagës kundër luftës së UÇK-së!

Ndryshe prej të parëve, këtë luftë e trajtojnë Shefkije Islamaj, Bedri Zyberaj dhe shkrimtari malazez me prejardhje shqiptare, Zuvdija Hoxhiq etj. Këta të fundit, secili në mënyrën e vet, e trajtojnë luftën si një fenomen me pasojat të mëdha humane, psikologjike, ekonomike dhe shoqërore. Nuk e politizojnë luftën, po merren me tragjiken e luftës, me sakrificat që njerëzit detyrohen të bëjnë për t'i mbijetuar asaj, si dhe me pasojat e luftës, të cilat zgjasin shumë më gjatë se vetë lufta. Ndërsa të parët zhyten në çështjen: kush kishte të drejtë e kush nuk kishte të drejtë, duke e harruar kështu thelbin e çështjes, të dytët futen në vetë thelbin e çështjes, duke e trajtuar luftën si një fatkeqësi që e ndjek njerëzimin që nga krijimi i shoqërisë njerëzore e deri në ditët tona, si një thimje kundër saj, si një përpjekje që, me katarsisin që përjetojnë njerëzit kur i lexojnë veprat e tyre, ta konsiderojnë luftën si një fenomen antinjerëzor, i cili duhet të tejkalohet.

- [1] Oliver Jens Schmitt, Kosova – histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike, Koha, Prishtinë, 2012, f. 253-254.
- [2] Po aty f. 325.
- [3] Ibrahim Kelmendi, Trileri i O. J. Schmittit për Kosovën, Gjon Buzuku & Epoka e re, Prishtinë, 2013.
- [4] Po aty f. 225.
- [5] Po aty f. 225.
- [6] Revista Fjala, nr. 3, mars 2001, f. 7.
- [7] Zuvdija Hoxhiq (Berisha), Të gjithë njerëzit e mi, Onufri, Tiranë 2017, f. 53.
- [8] Jusuf Buxhovi, Dosja B, f. 333.
- [9] Po aty, Dosja B, f. 333-334.
- [10] Bedri Zyberaj, Në gjumë të arketipeve, Institutit Albanologjik, Prishtinë, 2013, f. 203.
- [11] Po aty f. 206.
- [12] Bedri Zyberaj, tregimi Varret pa të vdekur, të vdekurit pa varre, revista Akademia, nr. 2, 2018, f. 233.
- [13] Aristotelit, Poetika, Buzuku, Prishtinë, 2010, f. 31.
- [14] Po aty f. 31.

(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)

Kryqëzatat krijuan kompaninë e parë të shërbimeve financiare në botë



Nga Tim BRINKHOF

Evropianët nisën të shkonin për pelegrinazh në Jerusalem pas Kryqëzates së Parë të nisur në vitin 1099, e cila u zhvilluar jo vetëm për të rimarrë nën kontroll Tokën e Shenjtë nga pushtimi islamik i Levantit, por edhe për të krijuar një rrugë tokësore për të krishterët që donin të vizitonin vendlindjen e besimit të tyre fetar.

Por edhe pas krijimit të këtij shtegu, vizita të tilla shoqëroheshin me jo pak rreziqe. Nëse gjithçka shkonte mirë, udhëtimi nga Italia në Jerusalem zgjaste për rreth 2 muaj. Pra po aq kohë sa iu desh emigrantëve anglezë që të mbërrinin në Nju Jork gjatë epokës koloniale.

Por zakonisht, pelegrinazhet zgjasnin më shumë sesa 2 muaj, sepse pelegrinët e ngadalësonin udhëtimin për shkak të luftës, sëmundjeve dhe grabitësve, kërcënime që vetëm sa shtoheshin sa më larg shtëpisë që ishin. Grabitjet ishin një dukuri e zakonshme, dhe kjo për arsye të kuptueshme.

Pelegrinët duhej të kishin me vete para të mjaftueshme për të paguar ushqimin dhe strehimin gjatë rrugës. Por ata ishin në përgjithësi të paarmatosur dhe të pa trajnuar për të luftuar në rast rreziku. Dhe kjo i shndërronte ata në objektivin e përsosur të hajdutëve.

Gjithsesi, për shumicën e pelegrinëve evropianë, grabitja ishte një rrezik që ata duhej të merrnin në sy, në rast se dëshironin që të shkonin në vendin ku besohej se ishte kryqëzuar dhe ringjallur Jezu Krishti. Megjithatë, udhëtarët britanikë kishin një mundësi për ta

minimizuar atë rrezik.

Në Londër, ekzistonte një organizatë e njohur si Kisha e Tempullit, ku pelegrinët mund të depozitonin një pjesë të kursimeve të tyre. Në këmbim, atyre iu jepej një letër në formën e çekut të sotëm, të cilën mund ta përdornin për të tërhequr kursimet e tyre pasi të mbërrinin në Jerusalem.

Shërbimet e Kishës së Tempullit e bënë shumë më të sigurt pelegrinazhin në Tokën e Shenjtë. Tani pelegrinët nuk kishin më nevojë të mbanin me vete shumë para kur niseshin për udhëtimin e tyre, duke zvogëluar mundësinë e joshjes së grabitësve për t'i sulmuar. Për më tepër, nëse do të grabiteshin, ata do të ishin në gjendje të rimbushnin financat e tyre në destinacionin e tyre. Për këtë arsye historianët shpesh i referohen organizatës si banka e parë në botë. Nëse shihet në këtë qasje, ajo i paraprin në kohë edhe bankës italiane "Banca Monte dei Paschi di Siena". Koncepti i Kishës së Tempullit për lëshimin e një çeku nuk ishte krejtësisht origjinal, pasi që në shekullin e VII të Erës Sonë, tregtarët kinezë mund të depozitonin pasurinë e tyre tek disa agjenci në këmbim të letrave me vlerë.

Dallimi kryesor ishte se këto agjenci ishin në varësinë e qeverisë kineze të dinastisë Shang, ndërsa Kisha e Tempullit ishte një ndërmarrje private.

Themeluesit e Kishës së Tempullit nuk ishin askush tjetër veçse legjendarët Kalorësit Tempullarë. Të njohur edhe si Bashkëlufëtarët e varfër të Krishtit dhe Urdhri i Tempullit të Solomonit, Tempullarët ishin një nga disa urdhrat ushtarakë të krishterë që u

ngritën në të gjithë Evropën për të siguruar shkuarjen e sigurt të pelegrinëve në Jerusalem.

Urdhri u themelua diku rreth vitit 1118 pas Kryqëzates së Parë, dhe anëtarët e tij luftuan në urdhrat që u themeluan më vonë si një forcë elitare. Midis betejave, ata ndërtuan dhe drejtuan fortifikime në të gjithë qytetin. Ajo ishte një mënyrë për të forcuar praninë e të krishterëve evropiane në Tokën e Shenjtë.

Por Kalorësit Tempullarë nuk ishin vetëm luftëtarë të shkëlqyer, ata ishin edhe financierë të zgjuar, duke luajtur një rol kyç në evolucionin e sistemit financiar të Evropës. Por pse Tempullarët në Londër u bënë bankierë? Në artikullin e saj "Marrëdhëniet financiare të kalorësve tempullarë me kurorën angleze", studiuesja Elenor Ferris spekulon se shërbimet financiare të këtij urdhri mund të kenë lindur nga "praktika e zakonshme mesjetare e depozitimit të objekteve me vlerë në vende të shenjtëruara për siguri gjatë kohërave të trazuar".

Vetë Kisha e Tempullit ishte një ndërtesë shumë e fortifikuar, e ndërtuar nga inxhinierë të aftë, e mbrojtur nga ushtarë shumë të trajnuar, dhe e vendosur në një nga vendet më strategjike të qytetit. Pra ishte një kasafortë e përsosur. Shërbimet financiare të Kalorësve Tempullarë nuk ishin të disponueshme vetëm për pelegrinët e krishterë, por edhe për publikun e gjerë.

Ferris përmend se "të gjitha kategoritë e personave që zotëronin pasuri" iu drejtuan Kishës së Tempullit për të ruajtur arin, argjendin dhe bizhuteritë e tyre gjatë shekullit XIII- të. Lista e klientëve të këtij urdhri përfshinte

edhe fisnikërinë angleze, e cila ruante atje taksat dhe detyrimet feudale përveç pasurisë së tyre personale.

Por edhe vetë Papa depozitoi atje shumë nga pasuria e Vatikanit. Dhe gjatë kryqëzates, ai kërkoi grante për të mbrojtur Tokën e Shenjtë nga pushtuesit myslimanë. Përveç ruajtjes së pasurisë për klientët individualë, "Western Union" i Evropës Mesjetare gjithashtu mund të transferonte fonde nga llogaria e një personi në atë të një tjetri.

Kështu në një rast, Kalorësit Tempullarë morën 40.000 marka nga Fallks de Brote, një ushtar në shërbim të mbretit anglez Xhon. Kur Dë Brote u internua për shkak të organizimit të një rebelimi të pasuksesshëm, Tempullarët ia dorëzuan paratë e tij mbretërisë angleze. Pesë vjet më vonë, ata transferuan në llogarinë e princit të kurorës Eduard rreth 10.000 marka që u ishin depozituar nga nënshetësit e tij. Kisha e Tempullit nuk mund të ishte themeluar pa kryqëzatat, kërkesat financiare, logjistike dhe ushtarake, të cilat nxorën në pah kufizimet e strukturës kryesore ekonomike të Evropës: sistemin feudal.

Sipas një disertacioni të shkruar nga Ronald Grosman për Universitetin e Çikagos me titull "Financimi i kryqëzates", këto kufizime u vunë re për herë të parë gjatë Pushtimit Norman të Anglisë, që ndodhi disa vjet përpara se ushtarët e krishterë të marshonin në Levant. Pushtimi Norman ishte një kryqëzatë në vetvete, pasi Uilliami i Normandisë u kërkoi zotërvetë tij vasalë të marshonin bashkë me ushtarët e tyre në një territor shumë përtej Normandisë.


Këta të fundit i thanë monarkut se nuk mund të detyroheshin të merrnin armët, bazuar vetëm në lidhjet e tyre shekullore feudale. Detyrimet e tyre ndaj Uilliam, mbaronte aty ku niste deti. Në këto kushte, Uilliam Pushtuesi u premtoi një sasi të konsiderueshme pasurish nga ishulli që do të pushtonin. Vasalët u bindën, dhe pjesa tjetër është histori.

Ironikisht, përfitimet e mëdha sollën edhe rënien e tyre. Kisha e Tempullit filloi të shkërmoqet në 1244, vit kur Jerusalem u pushtua nga ushtritë mercenare Kuarazmiane nga Iraku verior. Tashmë që Toka e Shenjtë nuk ishte më nën kontrollin evropian, pelegrinët evropianë pushuan së bëri pelegrinazhe.

Pa pelegrinazhe, ata nuk kishin asnjë arsye që t'i depozitonin kursimet e tyre në Kishën e Tempullit. Kjo bëri që fondet e saj të pakësoheshin gradualisht. Kalorësit Tempullarë rezistuan edhe për disa dekada të tjera pas kësaj pike. Ndonëse kishin humbur një pjesë të madhe të klientelës së tyre, shërbimet e tyre financiare mbetën të disponueshme për qytetarët e pasur dhe anëtarët e fisnikërisë evropiane.

Kjo deri në vitin 1307, kur mbreti francez Filip IV, i zhytur deri në fyt në borxhe ndaj urdhrat, filloi të arrestonte, torturonte dhe digte kalorësit tempullarë në Francë, derisa e bindi Papa Klementin V që të shpallte shpërbërjen e urdhrat të tyre në vitin 1312. Por ndërsa vetë Tempullarët nuk janë më sot, trashëgimia e murgjve luftëtarë jeton në të dhënat e kontabilistëve, administratorëve dhe bankierëve të Evropës.

"Big Think" – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Argjentina eliminon Holandën, në gjysmëfinale përballet me Kroacinë

DOHA, 9 DHJETOR - Argjentina ka siguruar një biletë për në gjysmëfinalen e Botërorit të Katarit. Kombëtarja e drejtuar nga Lionel Scaloni barazoi 2-2 me holandezët, në ndeshjen e luajtur në Lusail Iconic Stadium (Lusail), ndërsa as në shtesa nuk pati gola, çka bëri që gjithçka të "vulosej" nga 11-metërshat. Sfidu u zhblllokua në minutën e 35-të. Ishte Lionel Messi që me një assist magjik nxorri bluf disa lojtarë të "Tulipanëve" dhe shërbeu për Molinën, i cili dërgoi topin në rrjetë. Sërish Messi do ishte protagonist për kombëtaren e tij, çerek ore para fundi. Ylli i futbollit botëror realizoi golin e sigurisë nga pika e bardhë. Goli i Weghorst do rihapte përkohësisht takimin, ndërsa barazimi do vinte në fund nga i njëjti autor. Shtesa

nuk prodhoi gola dhe bileta u vendos vetëm pas ekzekutimit të penalltive. Më të saktë nga pika e bardhë u tregua kombëtarja "Albiceleste" (Gabuan Van Dijk, Berghuis), kure për Argjentinën penalltinë vendimtare e shënoi Martinez. Argjentina ka një pengesë mjaft të madhe përpara, ku për të shkuar deri në finale të Kompeticionit, duhet të eliminojë Kroacinë. Në krahun tjetër, skuadra e Van Gaal e mbyll këtu rrugëtimin e Botërorit të Katarit, me pengun më të madh: trofeun. Kroacia është skuadra e parë gjysmëfinaliste e Kupës së Botës, duke lënë jashtë Brazilin. Skuadra ballkanase mori një fitore të madhe nga ruleta e penalltive, pasi koha e rregullt përfundoi pa gola, ndërkohë që shtesa 1-1. Në minutën e 20-të, Vinicius Junior dhuron



spektakël në hyrje të zonës dhe pas një kombinimi godet fortë, por topi ndalet nga mbrojtësit. Kroacia nuk qëndroi aspak në mbrojtje, duke ushtruar presion në disa raste. Në pjesën e dytë, Selecao shtoi ndjeshëm presionin duke ju afruar dy herë golit me Neymar dhe Richarlison, por portieri Livakovic ishte në formë



fantastike. Ndeshja nuk do të ndryshonte deri në fundin e kohës së rregullt, duke shkuar në shtesë. Në minutën e 105, Neymar me një aksion shumë të bukur personal, arrin që të bëjë gjithçka mirë brenda zonës për të realizuar golin e avantazhit. Kroacia nuk u dorëzua, pasi do të barazonte shifrat në 1-1 ndaj Brazilit. Në minutën e 116-të,

Bruno Petkovic do të realizonte një gol fantastik, duke u ndihmuar dhe nga një devijim i mbrojtjes braziliane. Sfidu përfundoi në ruletin e penalltive, atje ku Kroacia tregoi se është një ekip specialist. Portieri Livakovic bëri një pritje fantastik ndaj Rodrygo, ndërkohë që në fund dhe Marquinhos goditi shtyllën.

Sot përballet e tjera çerekfinale Maroku - Portugalia dhe Anglia - Franca

AL KHOR, 9 DHJETOR (ER) - Në stadiumin "Al Bayt Stadium" dy kombëtarët gjigante të botës, Anglia dhe Franca, kërkojnë kualifikimin në gjysmëfinale të Botërorit 2022 i cili po mbahet në Katar. Anglia mposhti Senegalin në kuadër të 1/8 së finales, derisa në anën tjetër Franca e eliminoi Poloninë për ta siguruar kalimin në çerekfinale. "Tre Luanët" në katër ndeshjet e zhvilluar deri tash kanë pasur një sulm të frikshëm, pasi kanë shënuar 12 gola, derisa mbrojtja është treguar stabile dhe ka pranuar

vetëm dy gola. Në anën tjetër, "Gjelat", që janë kampionë në fuq të botës, në katër ndeshjet e zhvilluara kanë realizuar nëntë gola, kurse kanë pësuar katër gola, por një rezultat zhgënjyes e regjistruan në përballje me Tunizinë, të cilën e humbën me rezultat minimal 1-0. Në kuadër të çerekfinales në orën 16:00 zhvillohet edhe një tjetër ndeshje mjaft interesante, ku befasia më e madhe e këtij kampionati, Maroku, që eliminoi Spanjën në 1/8 e finales, e pret Portugalinë.

Marokenët do të mundohen t'i befasojnë edhe portugezët, të cilët, pas fitores ndaj Zvicrës (6-1), i kanë shtuar synimet për të shkuar sa më gjatë në këtë kompeticion. Ndërkohë mbetet të shihet se a do t'i japë besim përzgjedhësi i Santosit, Cristiano Ronaldo, që të nisë nga fillimi këtë ndeshje, apo sërish do të fillojë me Ramosin.

TË SHTUNËN TAKOHEN:

16:00 Maroku - Portugali
20:00 Angli - Francë



Saraçini, EHF-së: Dënojmë sjelljet shoviniste dhe fashiste të tifozëve serbë

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, i ka shkruar të premten letër Federatës Evropiane të Hendbollit dhe drejtuesve të saj. Përmes letrës, i pari i FHK-së, Saraçini, ka shprehur shqetësimin për thirrjet anti-shqiptare dhe anti-Kosovë si dhe për panot diskriminuese të shfaqura në ndeshjen e fundjavës së kaluar mes skuadrës slovene, Gorenje Velenje dhe skuadrës serbe, Partizani i Beogradit. Kjo ndeshje u luaj në Slloveni, kurse kishte thirrje diskriminuese të tifozëve serbë e, po ashtu, u shfaq



flamuri diskriminues i Serbisë mbi hartën e Kosovës. Presidenti i FHK-së ka kërkuar nga EHF-ja që të merren të gjitha masat që raste të tilla mos të ketë në palestrat e tjera. Më poshtë e paraqesim letrën që presidenti Eugen Saraçini ua ka dërguar sot EHF-së dhe drejtuesve të këtij

institucioni. "Të dashur miq të hendbollit, kemi marrë informacione se përsëri janë keqpërdorur rregulloret bazë të EHF-së. Në ndeshjen e hendbollit, Gorenje (Velenje) vs Partizan (Beograd), të luajtur në Velenje më 04.12.2022, janë dëgjuar thirrje kundër Kosovës nga grupi i tifozëve të Partizanit dhe këngë kundër shqiptarëve dhe Kosovës. Gjatë ndeshjes, në sallë u panë edhe flamujt e Serbisë me hartën e Kosovës në të cilët shkruhej 's'ka dorëzim', që njihet si slogani i të ashtuquajturës 'thirrje lufte', ka thënë Saraçini. "Miq të dashur,

edhe një herë strukturat politike serbe, përmes tifozëve të tyre në sallat e hendbollit, por edhe në sportet e tjera, po përpiqen në mënyrë agresive të sjellin atmosferën nacionaliste dhe të shfaqin sjellje shoviniste e fashiste mes adhuruesve të hendbollit dhe sporteve në përgjithësi. FHK-ja dënon ashpër një sjellje të tillë. I bëjmë thirrje të gjitha organeve përkatëse të EHF-së që të dënojnë dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme ndaj të gjithë protagonistëve në këtë ndeshje hendbolli në Velenje. Fatkeqësisht, duhet të dënojmë

edhe sjelljen e delegatit të EHF-së i cili "nuk ka parë dhe nuk ka dëgjuar" asgjë nga kjo që ka ndodhur. Ky incident, siç raportohet ka ndodhur edhe në ndeshjen e hendbollit në Austri ndërmjet UHK Krems dhe Vojvodinës. Ky duhet të jetë sinjal i qartë që EHF-ja të marrë masa. Shpresojmë se ndërmarrja e hapave të duhur do të minimizojë incidentet e ardhshme dhe do të maksimizojë atmosferën reale sportive dhe terrenin e sigurt për të gjithë tifozët e respektuar të hendbollit në të gjithë Evropën", ka shtuar Saraçini.

Deneveri mposhti Portlandin në sekondën e fundit

PORTLAND, 9 DHJETOR - Denveri ndodhet në grupin e skuadrave pretendente për kreun në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 121-120 arritur ndaj Portlandit jashtë fushës. Sfidë e vendosur në

sekondën e fundit, me Nikola Jokiqin protagonist. Ylli i Denverit realizoi 33 pikë e 10 rebounde, duke i bërë të pavlefshme 40 pikët e 12 asistimet e Lillardit për vendasit. Ekipi i Miami Heat, falë 31 pikëve

e 10 reboundeve të Adebayo dhe 26 të Butlerit, mposhti me rezultat 115-110 rivalët e Clippersave. Sfidë me rivalitet, ku për miqtë nuk mjaftuan 29 pikët e Paul Georges. Fitoi edhe San Antonio, që mundi me rezultat

118-109 Houstonin, me Johnsonin protagonist, autor i 32 pikëve, mbështetur edhe nga Jones me 26 pikë. Rezultatet: Miami-Clippers (115-110), San Antonio-Houston (118-109), Portland-Denver (120-121).



Mehmeti beson në kualifikimin e Besa Famgas

PEJË, 9 DHJETOR - Portieri Mursel Mehmeti është kthyer me sukses te Besa Famgas. Ai të dielën bëri 11 pritje për kampionen e Kosovës, por që nuk ishin të mjaftueshme në ndeshjen ndaj skuadrës kroate, Sesvete. Në Kroaci, Sesvete fitoi 31:23 ndaj Besa Famgas, në ndeshjen e parë të raundit të tretë të Kupës Evropiane. Ndeshja e kthimit luhet të dielën nga ora 19:00 në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Mehmeti beson fuqishëm se Besa ka forcë për ta kaluar Sesveten, ndonëse rezultati i ndeshjes së parë nuk është i favorshëm. Ai thotë se për sukses Besës i duhet përkrahja e shikuesve nga tribunat. "Ndeshja në Kroaci ishte shumë e fortë, mirëpo në fund nuk eci mirë për ne dhe kundërshtari e shfrytëzoi këtë duke e rritur epërsinë. Sa i përket ndeshjes në Pejë, tani e njohim më mirë kundërshtarin. Jemi mobilizuar dhe shpresojmë në



fitore. Presim edhe përkrahje nga publiku, por çdo gjë ia lëmë fushës", ka thënë Mehmeti. Besës në Kroaci i kushtoi rënia e koncentrimin në momentet e fushës. Pasi barazoi rezultat, pranoi dhjetë gola rresht dhe kështu Sesvete arriti te fitorja e

lartë. Ndeshja e dytë do të varet edhe nga forma e treshes së portierëve. Pos Mehmetit, Besa në portë i ka edhe Arti Luzhën dhe Flakrim Beqirajn. Besa Famgas në raundin e dytë të Kupës Evropiane e eliminoi Helsinkin.

Të bindur në Portugali: Pa Ronaldon fitojmë Botërorin

LISBONË, 9 DHJETOR - "Është një grup shumë i bashkuar për t'u përçarë nga forca të jashtme. Është një komb shumë i guximshëm për t'u trembur nga çdo rival". Me këto fjalë, Cristiano Ronaldo përpiqet ta qetësojë ambientin rreth përfaqësueses portugeze, ku zërat flasin për një përçarje mes CR7 dhe pjesës tjetër të ekipit, pikërisht për shkak të yllit luzitan që kërkon me insistim një vend si titullar. Që nga 2008 Ronaldo nuk e kishte shijuar kurrë stolin, por situata me sa duket ka ndryshuar shumë, ku zëvendësi i tij, Gonçalo Ramos, realizoi një "triletë" golash në debutimin e tij në Botëror. Zërat kundër Ronaldos sa vijnë e shtohen. I radhës që mendon se Portugalia është më e bukur pa Ronaldon, është ish-lojtari i përfaqësueses luzitane, Jose Fonte: "Kur Ronaldo nuk është, Portugalia luan më shumë si skuadër, kjo ishte shumë e dukshme përballë Zvicrës.



Luajtën në mënyrë fluide, pa një pikë referimi, të gjithë dhanë kontribut dhe ishin të bukur për t'u parë. Prania e tij në fushë i detyron lojtarët e tjerë të luajnë për të, t'i japin gjithnjë topin atij. E them me bindje, nëse Ronaldo nuk luan, Portugalia mund ta fitojë Botërorin". Tifozët portugezë

janë fiksuar keq pas idesë për ta parë Ramosin titullar ose, më saktë, kërkojnë që Ronaldo të ulet në stol me çdo kusht. A Bola ka ndërtuar një tjetër sondazh në lidhje me sfidën kundër Marokut, këtë herë janë jo pak, por 93 % e tifozëve që e duan Ronaldon në stol.

SHKURT

Reali interesohet për Muriqin

Vedat Muriqi është duke kaluar nëpër formë të mirë me fanellën e skuadrës së Mallorcës, por edhe me Përfaqësuesen e Kosovës. Interesim për shërbimet e sulmuesit shtatlartë nga Prizreni kanë shfaqur disa skuadra, përfshirë edhe Real Madridin. Sipas "Damiano er Faina", klubi madrilen ka kërkuar informacione për Muriqin. Muriqi do të ishte një zëvendësues i Karim Benzemas, kur francezi nuk është i gatshëm për lojë. Deri tash sulmuesi "dardan" ka shënuar 7 gola.

Khaka: Rikthehemi më të fortë

Mesfushori shqiptar i Përfaqësueses së Zvicrës, Granit Khaka, ka reaguar në rrjetet sociale disa ditë pas eliminimit nga Kupa e Botës "Katar 2022". Zvicra u eliminua në fazën e 1/8-s pasi u mposhtë nga Portugalia me rezultat të thellë 6-1. Kapitani i Zvicrës ka falënderuar të gjithë për mbështetjen tekta shton se do të rikthehen edhe më të fortë. "Ndonjëherë futbollit dhemb. Vërtet për të ardhur keq që Kupa jonë e Botës përfundoi ashtu siç përfundoi. Por dua t'ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen tuaj gjatë turneut - kjo do të thotë vërtet shumë për ne. Do të japim gjithçka për t'u rikthyer më të fortë", ka shkruar Khaka në "Instagram".

Pas 10 muajsh e burgosur në Rusi, lirohet basketbollistja Brittney Griner

Ylli WNBA-së, Brittney Griner, mbërriti në Kelly Field të San Antonios, në Teksas, një ditë pas shkëmbimit të të burgosurve me Rusinë, shkruan CNN. Griner qëndroi 10 muaj pas hekurave në Rusi përpara se të lirohej në një shkëmbim të profilit të lartë të të burgosurve që përfshinte tregtarin e dënuar rus të armëve Viktor Bout. Në shkurt, autoritetet në një aeroport në zonën e Moskës gjetën Griner me më pak se një gram vaj kanabisi në bagazhin e saj. Ajo u dënua për trafikim të drogës dhe u dënua me nëntë vjet burg. Në nëntor ajo u transferua në një koloni penale për ta vuajtur dënimin.

Santos: Nuk do të jetë e lehtë ndaj Marokut

Trajneri i Portugalisë, Fernando Santos, foli në një konferencë për shtyp para ndeshjes kundër Portugalisë. Ai vlerësoi Marokun si një kundërshtar i vështirë, ndërkohë që komentoi edhe zhvillimet e fundit për Cristiano Ronaldon. "Maroku është një ekip shumë i fortë. Është një ekip jashtëzakonisht i organizuar me lojtarë që luajnë për Chelsea, PSG-bë ose Bayern Munichun. Ne duhet të gjejmë zgjidhje. Nuk është një ndeshje e lehtë për Portugalinë. Duhet të luajmë pa frikë dhe me besim. Nëse e bëjmë këtë, jam i sigurt se do të fitojmë, por mendoj se trajneri i Marokut ndihet në të njëjtën mënyrë. Ronaldo? Mendoj se është koha ta lëmë të qetë. Ai asnjëherë nuk ka thënë se donte të largohej nga kombëtarja jonë dhe mendoj se ka ardhur koha për t'i ndalur polemikat", ka deklaruar strategu i Portugalisë.

Capello: Në Katar festuam fundin e 'tiki-taka'-s

Pas eliminimit të Spanjës nga Maroku, Fabio Capello është shprehur se ky Kampionat Botëror solli fundin e futbollit që

aplikojnë "tiki-taka". "Në Katar festuam fundin e 'tiki-taka'-s. Spanja i thotë lamtumirë 'nëntështes false'. Është diçka që mund të

funksionojë në disa raste, por nuk mund të shndërrohet në sistem. Prania e një sulmuesi është thelbësor. Posedimi i topit?

Kur nuk shoqërohet me shpejtësi, nuk është produktiv. Futbollit i Pep Guardiols ka evoluar në krahasim me dhjetë vjet më parë. Por le të

kujtojmë se Barcelona atëherë kishte yje si Messi apo Iniesta në maksimumin e tyre për ta zbatuar planin", ka deklaruar Capello.



Në bazë të nenit 21 paragrafi 21.4 e Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087, si dhe Plotesim Ndryshimi i Ligjit mbi NP Nr.04/L-111, si dhe Kodi Etikes dhe Qeverisjes Korporative, Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi" SHA-Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me 30.11.2022, vendosi të publikoi këtë:

KONKURS Për plotësimin e pozitës:

Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.

Vendi i Punës: Prishtinë

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Kohëzgjatja e emërimit: Mandati për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv është 3 vjeçar.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Të menaxhoj kompaninë në baza ditore në pajtim me aktet ligjore dhe politikave të kompanisë,
- Të zbatojë qëllimet strategjike dhe objektivat e kompanisë duke i dhënë drejtim lidhës drejt arritjes së misionit dhe vizionit të kompanisë,
- Mbështet punën e Bordit të Drejtorëve me anë të propozimeve lidhur me politikave dhe vendimet që do të merr Bordi;
- Është përgjegjës për shërbimet që ofron kompania duke mbikqyrë kualitetin e programit të përgaditjes së shërbimeve, marketingun dhe shitjen e këtyre shërbimeve,
- Propozon buxhetin vjetor për aprovim të Bordit të Drejtorëve, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme,
- Në mënyrë efektive menaxhon resurset njerëzore të kompanisë brenda politikave zyrtare të kompanisë dhe procedurave konform ligjeve në fuqi,
- Siguron që misioni dhe programi i Kompanisë dhe i shërbimeve të saj, të jenë në mënyrë të vazhdueshme dhe fuqishëm të prezantuara për të krijuar një pasqyrim pozitiv të kompanisë të palët e interesit,
- Mbikqyrë ngritjen e fondeve, planifikimin dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë identifikimin e burimeve të financimit, si dhe përgaditjen e strategjisë për të i'u qasur këtyre burimeve duke ofruar propozim për administrimin dhe dokumentimin e ngritjes së këtyre fondeve,
- Menaxhon politika dhe zbaton vendimet e Bordit në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të vecanta:

- të kenë diplome universitare nga fusha ekonomike, juridike, teknike, shoqërore ose të ngjajshme.
- të kenë përvojë profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues në insitucione shtetërore ose ndërmarrje publike
- të kenë integritet të lartë moral e profesional,
- të kenë aftësi të dëshmuara në udhëheqje ose menaxhim,
- njohja e gjuhëve të huaja do të ketë përparësi,
- të mos jenë të dënuar ose nën hetime.

Aplikacionit për pozitën e KE-se duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- CV-ne (Biografine),
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Planin personal zhvillimor strategjik të ndërmarrjes për 3 vitet e ardhshme
- Letër motivimin,
- Deklaratën nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje, (e noterizuar)
- Certifikatën që nuk është nën hetime .

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

Duhet të kenë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri bazike në programet e kompjuterit, përvojë 5 vjet në nivelin drejtues dhe në fusha që ndërlidhen me menaxhim të insitucioneve apo ndërmarrjeve publike, njohja e gjuhëve të huaja është e dëshiruar.

Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

Procedura për aplikim: Aplikacioni merret në Kompani, të njëjtit i bashkëngjiten dokumentet deklarata nën betim, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës, dëshminë nga trusti pensional, dëshminë për përvojën, dëshminë se nuk janë nën hetime apo të dënuar për vepër penale dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale në Gjakovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.01.2023 në ora 10:00 në Spitalin e Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë (kati -I- salla e mbledhjeve) do të organizohet debat publik nga Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale në Gjakovë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/3409641600?pwd=VmZhelJZcHhpa3h6cGR6VFphOEJsUT09>

Meeting ID: 340 964 1600

Passcode: 7pxkmk

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Spitalin e Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë për trajtimin - sterilizimin e mbeturinave medicinale në Gjakovë.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Newco Agromorava L.L.C. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me nr. Unik Identifikues 810510835 bënë shpalle në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 216,750.00€ në zero euro (0).

- Arta Sheqeri B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810900771.

Kujtim Kyqyku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

Behim Alimi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

Mihrem Bajra shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

Floridan Begaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.

Myrvete Kurti shpalle te pavlefshme dëftesën nga klasa 1-8 te shkollës fillore Musa Hoti (Ish Meto Bajraktari).

D.P.H " Break Time Caffe" shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 70916479.

Albina Hoxhaj shpalle te pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHMLM " De Xheladin Deda".

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

